



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

# **R A P O R T**

**Për**  
**Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**1 Janar – 31 Dhjetor**  
**Viti 2014**

**Tiranë, Shkurt 2015**





# PËRMBAJTJA

<b>A. VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË</b>	Fq. 5
<b>A.1.</b> Burimet njerëzore	5
<b>A.2.</b> Buxheti i KQZ-së për vitin 2014	6
<b>A.3.</b> Raportet financiare vjetore të partive politike për vitin 2014	7
<b>A.4.</b> Auditimi i fondeve të partive politike	8
<b>A.5.</b> Shpërndarja e fondeve vjetore partive politike për vitin 2014	8
<b>A.6.</b> Hapja e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013.	11
<b>A.7.</b> Plotësimi i vakancave në Kuvend.	12
<b>B. VEPRIMTARI DHE REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E KODIT ZGJEDHOR</b>	13
<b>B.1.</b> Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: "Ushtrimi i të drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar"	14
<b>B.2.</b> Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: "Shanset e barabarta dhe respektimi i kuotës gjinore elektorale".	15
<b>B.3.</b> Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: "Fushata zgjedhore dhe media, sfida për të ardhmen"	18
<b>B.4.</b> Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: "Praktikat më të mira dhe platformat e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë".	20
<b>B.5.</b> Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: "Financimi i partive politike gjatë fushatës zgjedhore".	22
<b>B.6.</b> Konferenca "Kodi Zgjedhor mundësi për përmirësime": KQZ i përcjell Kuvendit të Shqipërisë paketën me gjetjet dhe rekomandimet e tryezave teknike të zhvilluara.	27
<b>B.7.</b> Përmirësime në Kodin Zgjedhor për aspekte të tjera të procesit zgjedhor.	28
<b>C. TRAJNIME TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR ADMINISTRIMIN ZGJEDHOR JASHTË PERIUDHËS ZGJEDHORE PËR PERSONA TË INTERESUAR</b>	29
<b>D. ORGANIZIMI I PROGRAMEVE PËR EDUKIMIN ZGJEDHOR TË SHTETASVE JASHTË PERIUDHËS ZGJEDHORE</b>	33
<b>E. KËRKESA PËR REFERENDUM VENDOR NGA GRUPE NISMËTARE</b>	35
<b>E.1.</b> Shqyrtimi i kërkesave nga grupet nismëtare, për fillimin e procedurave përkatëse, për zhvillimin e referendumeve vendore në disa njësi të organeve të qeverisjes vendore.	35
<b>F. VEPRIMTARIA E KQZ-SË PËR PËRGATITJEN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE 2015</b>	36
<b>F.1.</b> Përditësimi i moduleve/programeve kompjuterike të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë 2013, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015.	36
<b>F.2.</b> Plani Orientues i Veprimeve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 21 qershorit 2015.	37
<b>G. AKTIVITETE TË PËRGJITHSHME ME PARTNERË NDËRKOMBËTARË</b>	38
<b>G.1.</b> Bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit	38
<b>G.2.</b> Anëtarësimi dhe përfaqësimi i KQZ në aktivitetet e Mekanizmave Ndërkombëtar Zgjedhore.	39
<b>G.3.</b> Vëzhgimi i proceseve zgjedhore	40
<b>G.4.</b> Vizita studimore	40





## **I.VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË**

### **A.1. Burimet njerëzore**

Menaxhimi i burimeve njerëzore është proces i zhvillimit dhe mbajtjes së një force pune të talentuar dhe energjike për të mbështetur misionin, objektivat dhe strategjitë organizative dhe në këtë kontekst është një pikë kyçe për ecurinë e proceseve zgjedhore që funksionon në bazë të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Një personel i aftë, i trajnuar dhe i motivuar është kusht për zhvillimin dhe mirëfunksionimin e administratës publike, e cila kryesisht në proceset zgjedhore kontribuon si një formacion i nëpunësve civilë apo punonjësve mbështetës të institucionit, të orientuar me përkushtim në kryerjen e detyrave, paanësisë, transparencës dhe profesionalizmit drejt rezultateve konkrete pozitive të domosdoshme në zhvillimin e një procesi zgjedhor.

Në zbatim të nenit 21, pika 21 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në Referencë të ligjit nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", VKM Nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të kishte ndryshuar strukturën organike, për ta përshtatur atë sipas akteve të sipërcituara.

Ngërçi i deritanishëm ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të kourumit të KQZ-së, pasi për miratimin e ndryshimit të strukturë-organikës së KQZ-së kërkohet shumicë e cilësuar.

Në këto rrethana, nevojë imediate ngelet riorganizimi i stukturë-organikës së KQZ-së, në të cilën duhet të reflektohen të gjitha ndryshimet përkatëse në fushën e legjislacionit të Statusit të nëpunësit Civil, në bazë të të cilit funksionon administrata e KQZ-së.

Strukturë organika e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është e përbërë nga 7 anëtarë, 30 nëpunës civilë dhe 18 punonjës mbështetës, nga të cilët në nivele drejtuese administrative, janë pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive (7) dhe Përgjegjës Sektori (4).

Përsa i përket procedurave të ndryshme të rekrutimit, ky vit përkoji me një ndryshim në Ligji nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, Megjithë vështirësitë e implementimit të ligjit të ri, Burimet njerëzore në institucion kanë vlerësuar dhe punuar maksimalisht për menaxhimin dhe zbatimin e akteve ligjore e nënligjore përsa i përket procedurave të rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese.

Konkretisht gjatë këtij viti janë kryer:



1. Rekrutimi për 10 punonjës organikë, përkatësisht,
  - Punonjës në nivel drejtues 5(pesë), Punonjës në nivel ekzekutiv 5(pesë).
2. Përpilimi i akteve të deklaratimit të statusit të nëpunësit civil, pas verifikimit të procedurave të punësimit të punonjësve civilë, ku rezultoi se të gjitha rekrutimet ishin kryer në zbatim të plotë të legjislacionit për pranimin në shërbimin civil.
3. Formulimi dhe përshtatja sipas kërkesave të këtij ligji dhe aktit nënligjor të përshkrimeve të punës për çdo pozicion pune.
4. Përfundimi i procesit vjetor të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave sipas formularit të miratuar me VKM nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin në punë të punonjësve civilë".
5. Zhvillimin e procedurave të vlerësimit të performancës së çdo nëpunësi civil, për vitin 2014.

Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), janë kryer trajnimet e detyrueshme për punonjësit në periudhë prove, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, janë zhvilluar trajnime të nëpunësve të tjerë të administratës së KQZ-së në bashkëpunim me ASPA, apo edhe me organizatat ndërkombëtare ku shkëmbimi i eksperiencës apo vizitave studimore në vende të ndryshme kanë sjellë rritje së performancës, kualifikimit dhe ngritjes së nivelit profesional të administratës së KQZ-së, për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

## A.2. Buxheti i KQZ-së për vitin 2014

Me ligjin nr.185/2013 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2014", Komisionit Qendror të Zgjedhjeve iu akordua një fond prej 91.080.000 lekësh për funksionimin e institucionit dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore, të detajuara si më poshtë:

Shpenzime për paga	60.000.000 lekë
Shpenzime për sigurime	8.000.000 lekë
Shpenzime për mallra dhe shërbime	16.680.000 lekë
Transferta korrente të huaja	200.000 lekë
Transferta për buxhetet familjare dhe individët	3.200.000 lekë
Investime	3.000.000 lekë

Duke analizuar strukturën buxhetore për vitin kalendarik 2014 rezulton se 96.7 % të fondeve janë akorduar për shpenzime korrente dhe 3.3% e fondeve janë akorduar për investime.

Fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit u përdorën me efikasitet në përputhje me legjislacionin në fuqi për manaxhimin e fondeve publike. Nga 91.08 milionë lekë të akorduara, u realizuan 72.6 milionë lekë ose 78.7% e fondeve të akorduara. Diferenca prej 18.481 milionë lekësh konsiston në 12.19 milionë lekë në zërin "paga dhe sigurime" për anëtarët dhe administratën e KQZ-së, 0.9 milionë lekë në zërin "shpenzime për mallra dhe shërbime", 2.795 milionë lekë në zërin "transferta për buxhetet familjare dhe individët" dhe 2.5 milionë lekë në



zërin "investime".

Arsyet e këtyre mosrealizimeve në buxhetin e institucionit janë: në zërin "paga dhe sigurime" për shkak të mungesës së 3 anëtarëve të KQZ-së si edhe për shkak të disa vendeve të paplotësuara në administratë, në zërin "shpenzime për mallra dhe shërbime" për shkak të diferencave që rezultuan nga procedurat tenderuese, në zërin "transfera për buxhetet familjare dhe individët" për shkak të ndryshimit të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publike dhe nëpunësit civile", gjithsesi kjo diferencë prej 2.795 milionë lekësh u rialokua dhe u përdor nga ana jonë për hapjen e kutive të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin të datës 23 qershor 2013, në zërin investime.

### **A.3. Raportet financiare vjetore të partive politike në vitin 2014**

Në zbatim të Nenit 23, të Ligjit nr.10374, datë 10.02.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar", partitë politike duhet të dorëzojnë pasqyrat financiare në KQZ. Modeli i këtij raporti, në zbatim të ligjit të sipërcituar, (neni 15/2), është miratuar me vendimin e KQZ-së nr.3, datë 18.01.2012 "Për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar të ekspertëve kontabël". Afati i dorëzimit të këtij raporti, miratuar me vendimin e KQZ-së nr. 14, datë 23.11.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 3, datë 18.01.2012 "Për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar të ekspertëve kontabël", është data 31 mars e vitit pasardhës. KQZ i publikon këto raporte financiare në faqen e saj zyrtare brenda 30 ditësh nga dorëzimi i tyre. Lëvrimi i fondeve publike bëhet vetëm pasi partia politike ka dorëzuar në KQZ pasqyrat financiare të vitit pararendës. Për këtë arsye, pranë KQZ-së depozitojnë pasqyrat financiare vetëm ato parti politike që përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit. Kështu, nga 124 prej partive politike të regjistruara në regjistrin e partive pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë dorëzuar pasqyra financiare në KQZ në vitin 2014, partitë politike si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë
2. Partia Demokratike e Shqipërisë
3. Partia Republikane Shqiptare
4. Lëvizja Socialiste për Integrim
5. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
6. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
7. Partia Demokristiane e Shqipërisë
8. Partia Kristian Demokrate
9. Fryma e Re Demokratike
10. Partia Bashkimi Liberal Demokrat
11. Partia Civile
12. Partia Aleanca Popullore



13. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë

14. Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen-MEGA

#### **A.4. Auditimi i fondeve të partive politike për vitin 2013**

Për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2013, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji "Për partitë politike", KQZ me vendimin nr.15, datë 30.04.2014 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël që do të auditojnë fondet e partive për vitin 2013", përzgjedhi me short dhe emëroi 22 ekspertë kontabël të licensuar për auditimin e 124 partive politike të regjistruara në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. U paraqitën pranë KQZ-së për të lidhur kontratën e shërbimit vetëm 21 ekspertë kontabël, . Ndonëse kanë lidhur kontratën me KQZ-në, (pranë Drejtorisë Juridike), dhe kanë marrë përsipër të kryejnë auditim, 5 ekspertë kontabël nuk e përmbushën detyrimin e tyre për të audituar fondet e partive për vitin 2013. Këta ekspertë duhet të auditonin në total 34 parti politike.

Si përfundim, bazuar në raportet e auditimit të dorëzuara dhe informacionin e depozituar pranë KQZ-së nga ekspertët kontabël të përzgjedhur dhe emëruar nga KQZ për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 90 partitë politike për vitin kalendarik 2013, rezulton se në asnjë rast nuk evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", dhe për këtë arsye ekspertët nuk kanë propozuar vendosje sanksionesh me gjobë për ndonjë parti.

#### **A.5. Shpërndarja e fondeve vjetore partive politike për vitin 2014**

Në zbatim të Nenit 15/2, pika 2, germa e të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore. Ligji nr.185/2012, datë 02.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2014", kishte të parashikuar fondin prej 190 milionë lekësh si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2014.

Neni 19, pika 2, e Ligjit "Për partitë politike", i ndryshuar, përcakton rregullat sipas së cilave bëhet shpërndarja e fondeve vjetore për partitë politike:

- a) 70 për qind, sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor;
- b) 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare;
- c) 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.

KQZ bazuar në ligjin "Për buxhetin e vitit 2014", në ligjin "Për partitë politike", në Vendimin e





KQZ-së nr.759, datë 06.08.2013 "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin të datës 23 qershor 2013", me vendimin nr.3, datë 20.01.2014 "Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike", shpërndau 190 milionë lekë ndërmjet partive politike, si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë	75.938.521 lekë
2. Partia Demokratike	59.441.771 lekë
3. Levizja Socialiste për Integrim	22.837.891 lekë
4. Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	9.779.951 lekë
5. Partia Republikane Shqiptare	8.893.981 lekë
6. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	6.392.441 lekë
7. Partia Kristian Demokratike e Shqiperise	6.392.441 leke
8. Fryma e Re Demokratike	323.000 lekë

Pas miratimit me vendim nga KQZ të sasisë së fondit publik që përfitonin partitë politike, Ligji nr. 17/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", ndryshoi nenin 19 të tij, rregullat për përcaktimin e masës së fondit publik që përfiton çdo parti politike. Në bazë të nenit 19, germa b të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike", i ndryshuar, 20% e fondit ndahet midis partive parlamentare dhe partive që kanë marrë mbi 10 000 vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Gjithashtu ligji i sipërcituar sipas nenit 2 të tij, hynte në fuqi më datë 30.03.2014 dhe nuk parashikonte efekte financiare që do të ndikonin në shpërndarjen e fondeve publike për vitin 2014.

Partia Demokristiane, Partia Socialdemokrate, Partia Demokracia Sociale, Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Aleanca Kuq e Zi, paraqitën në KQZ kërkesën me objekt, "Për rishikimin e vendimit nr.3, datë 20.01.2014 të KQZ-së "Për Shpërndarjen e Fondeve vjetore Partive Politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2014".

KQZ me vendimin nr. 14, datë 29.04.2014 "Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokristiane, Partisë Socialdemokrate, Partisë Demokracia Sociale, Partisë Fryma e Re Demokratike, Partisë Aleanca Kuq e Zi, "Për rishikimin e vendimit Nr.3, datë 20.01.2014 të KQZ-së "Për Shpërndarjen e Fondeve vjetore Partive Politike në formën e ndihmës Financiare vjetore për vitin 2014". vendosi rrëzimin e kërkesës.

Kundër vendimit nr. 14, datë 29.04.2014 KQZ, subjektet e interesuara bënë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 4355, datë 23.07.2014 vendosi të shpall moskompetencën lëndore dhe dërgimin e akteve Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë pasi morri në shqyrtim çështjen administrative me vendimin nr. 1, datë 6.10.2014 vendosi, Pushimin e gjykimit të çështjes, dërgimin e saj Gjykatës së Lartë për t'u shprehur lidhur me Vendimin nr. 4355, datë 23.07.2014 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Ligji nr. 125/2014 "Për një shtesë në ligjin nr.17/2014 "Për një shtesë në ligjin nr.8580, datë



17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshur", në nenin 1/1 të tij ka përcaktuar se efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, për vitin buxhetor 2014, shtrihen vetëm për periudhën nga hyrja në fuqi e tij deri në fund të vitit që i korrespondon periudhës nga 30 marsi deri në fund të vitit.

Me hyrjen në fuqi të tij, listës së partive politike që përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit si mbështetje financiare për aktivitetin vjetor të tyre, i shtohen edhe partitë politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare, si më poshtë:

1. Partia Demokracia Sociale	11,891 vota
2. Partia Socialdemokrate	10,220 vota
3. Partia Demokristiane e Shqipërisë	13,288 vota
4. Aleanca Kuq e Zi	10,196 vota

Për këtë arsye, KQZ me vendimin nr.22, datë 31.10.2014 "Për rishpërndarjen e fondeve vjetore partive politike për periudhën prill – dhjetor 2014", rishpërndau shumën prej 142.5 lekësh ndërmjet 12 partive politike. Në këtë mënyrë, 190 milione lekë të akorduara nga buxheti i shtetit si ndihmë financiare vjetore për partitë politike për vitin 2014, u shpërnda ndërmjet 12 partive politike si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë	74.242.093 lekë
2. Partia Demokratike e Shqipërisë	57.745.343 lekë
3. Levizja Socialiste për Integrim	21.141.463 lekë
4. Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	8.083.523 lekë
5. Partia Republikane Shqiptare	7.197.553 lekë
6. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	4.696.013 lekë
7. Partia Kristian Demokratike e Shqipërisë	4.696.013 lekë
8. Fryma e Re Demokratike	2.698.000 lekë
9. Partia Demokracia Sociale	2.375.000 lekë
10. Partia Socialdemokrate	2.375.000 lekë
11. Partia Demokristiane e Shqipërisë	2.375.000 lekë
12. Aleanca Kuq e Zi	2.375.000 lekë

KQZ, si del dhe nga raportimi i veprimtarisë së mësipërme, në bazë të Kodit Zgjedhor dhe ligjit "Për Partitë Politike" kontrollon dhe bën transparent për publikun, financat e partive politike gjatë fushatës zgjedhore, si dhe fondet e përfutuara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë viti kalendarik. Për këtë aspekt të rëndësishëm dhe problematikat që mbart ky proces, KQZ në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare, përfaqësues të partive politike, ekspertë të fushës dhe grupe interesi bëri analizë të hollësishme, e trajtuar kjo në zhvillimin e Tryezës Teknike, "Financimi i partive politike gjatë fushatës zgjedhore".

Në mënyrë që kontrolli dhe transparenca e financave të partive politike, të funksionojë sipas parimeve dhe normave të sanksionuara në dokumentat ndërkombëtare, KQZ ka hartuar dhe një pakete rekomandimesh të cilat i kemi pasqyruar më poshtë në mënyrë të hollësishme.



## **A.6. Hapja e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013.**

Ndër veprimtaritë e kryera gjatë vitit 2014, veçojmë hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013 si një detyrim ligjor që KQZ-ja ka në zbatim të nenit 178, pika 6 të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ me Vendimin nr.17, datë 17.09.2014, caktoi datën 1.10.2014 për fillimin e procedurave për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013. Gjithashtu, KQZ me Vendimin nr.16, datë 17.09.2014, miratoi buxhetin për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore.

Bazuar në Vendimet e sipërpërmendura të KQZ-së, Komisioni për hapjen e kutive të votimit filloi punën më datë 01.10.2014, organizoi grupet e punës për kryerjen e procesit të ndarë në bazë Qarku/KZAZ-je. Për çdo KZAZ mbi bazë qarku, u hapën kutitë dhe u krye seleksionimi dhe verifikimi paraprak i dokumentacionit, i cili më pas u administrua nga KQZ dhe u regjistrua në një bazë të dhënash, për t'u dorëzuar në Arkivin Qendror të Shtetit. Sipas nenit 176, pika 6 dhe Vendimit të sipërcituar të KQZ, dokumentacioni i cili u arkivua është:

1. Lista e zgjedhësve
2. Regjistri i posaçëm i zgjedhësve
3. Procesverbal PV-KQV-07
4. Procesverbal PV-KQV-08

KQZ me Vendimin nr.23, datë 14.11.2014 "Për një ndryshim në pikën 1 të Vendimit nr.8, datë 10.02.2014 "Për miratimin e mënyrës së asgjësimit të fletëve të votimit dhe shpenzimeve buxhetore, për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23.06.2013", ka përcaktuar mënyrën e asgjësimit të fletëve të votimit, me djegie.

Bazuar në Vendimin e sipërcituar, për të minimizuar efektet negative për mjedisin, fletët e votimit, falë ndihmës jo në vlerë financiare dhe mirëkuptimit të kompanisë "Kurum Sh.a" u asgjësuan në furrat e kësaj kompanie. Transporti i fletëve të votimit referuar volumit të tyre dhe në pamundësi të mjeteve të transportit të KQZ-së, u krye nga Ministria e Mbrojtjes, për të cilën gjejmë rastin ta falenderojmë për bashkëpunimin dhe gadishmërinë e treguar në këtë drejtim. I gjithë ky proces u mbikqyr nga stafi i KQZ-së.

Në përfundim të këtij procesi, kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore së bashku me materiale të tjera të ripërdorshme do të jenë pjesë e logjistikës zgjedhore që do të përdoret për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore për vitin 2015.



## A.7. Plotësimi i vakancave në Kuvend

Gjatë vitit 2014, KQZ shqyrtoi 13 kërkesat e ardhura nga Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit për njoftimin e krijimit të vakancave për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të disa deputetëve, nga zona zgjedhore të ndryshme

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ për krijimin e vakancës dhe KQZ merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Ndryshimet e vitit 2012 në Kodin Zgjedhor për herë të parë parashikuan përjashtimin nga rregulli bazë i zëvendësimeve në nenin 64, pika 2 dhe vendosjen e sanksionit plotësues, në nenin 175, pika 2.

Sipas këtyre dispozitave kur vakanca i përket një mandati të fituar nga gjinia më pak e përfaqësuar, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse. Gjithashtu kur ndaj një subjekti zgjedhor është konstatuar shkelja në lidhje me barazinë gjinore KQZ zbaton si sanksion plotësues zëvendësimin e cdo vakance më kandidat nga gjinia më pak e përfaqësuar.

Në cdo rast KQZ verifikoi listat shumëmemërore nga të cilat kishin dalë deputet e dorëhequr dhe konkretisht plotësimin e kriterit të gjinisë, të përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor. Në ato raste kur subjekti zgjedhor nuk e kishte plotësuar kriterin e gjinisë në listat shumëmemërore dhe kishte marrë sanksion administrativ me gjobë, KQZ në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, zbatoi dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

Një vëmendje të veçantë KQZ i kushtoi dhe zëvendësimit të vakancave sipas përjashtimit të përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Në rastet kur vakanca i përkiste një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor sipas të cilit nëse përpara krijimit të vakancës mandati i përkiste kandidatit nga gjinia më pak e përfaqësuar, plotësimi i vakancës u bë nga kandidati i radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

Edhe pse Kodi Zgjedhor, parashikoi si sanksionin plotësues zëvendësimin e cdo vakance në listën e subjektit, në zonën zgjedhore ku është konstatuar shkelja e kriterit të gjinisë, me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar, nuk u arrit qëllimi i kërkuar. Pas zëvendësimeve të bëra nga KQZ, si pasojë e dorëheqjeve nga madati i deputetit, në përbërjen e Kuvendit numri i deputeteve femrave aktualisht është **29 ose 20.71 %**.

Përbërja e Kuvendit pas zgjedhjeve të vitit 2013 nga 140 deputet gjithësej vetëm **25 ose 17.86 % ish in femra**.

Nga 20 ndërprerjet e mandateve dhe zëvendësimet e vakancave të kërkuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (gjatë vitit 2013-2014), numri i deputeteve femra u rrit vetëm 4. Kjo dhe për faktin se KQZ në 6 raste edhe pse subjektet garuese në zgjedhje kishin marrë sanksion administrativ me gjobë, nuk ariti të zbatonte sanksionin plotësues të parashikuar nga neni 175, pika 2 e Kodit Zgjedhor, për shkak të shterimit të kandidateve femra nga listat shumëmemërore. Në këto raste, mandati i kalonte kandidatit mashkull të listës shumëmemërore.



## B. VEPRIMTARI DHE REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E KODIT ZGJEDHOR

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka analizuar me shumë seriozitet çdo moment të punës së tij, bazuar edhe në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet për Kuvend të datës 23 qershor 2013. E tillë ishte dhe zhvillimi nga KQZ i analizës së punës intensive dy-ditore në prezencë të përfaqësuesve të OSBE-së, KiE dhe përfaqësuesve të partive politike, e cila qartësoi nevojën për ndryshime dhe përmirësime, si të anës legislative, kryesisht të Kodit Zgjedhor, ashtu edhe të anës organizative të vet KQZ-së.

Në këtë kontekst, për herë të parë KQZ, me mbështetjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë: Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Zyrës së Këshillit të Europës, UN Ëomen, mori nismën për organizimin e pesë tryeza teknike, të cilat trajtuan:

- Ushtrimi i së drejtës për të votuar të personave me aftësi të kufizuara (24 tetor 2013);  
(mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri);
- Shanset e barabarta dhe respektimi i kuotës gjinore në zgjedhje (22 janar 2014);  
(mbështetur nga UN ËOMEN)
- Fushata zgjedhore dhe media (3 mars 2014);  
(mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri)
- Praktikat më të mira të platformës së trajnimit të komisionerëve zgjedhorë (31 mars 2014);  
(mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Zyra e Këshillit të Europës)
- Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore (14 maj 2014)  
(mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri)

Diskutimi i hapur dhe gjithpërfshirës nga përfaqësues të partive politike, të organizatave të shoqërisë civile, të institucioneve shtetërore qendrore dhe të pavarura, të përfaqësuesve të mediave, të ekspertëve, të trupës së KQZ-së dhe administratës së saj, ofroi për çdo aspekt të temave të trajtuara, gjetje dhe përfundime të cilat do të shërbejnë për zgjidhje të suksesshme të sfidave që një proces zgjedhor mbart, dhe që për nga vetë natyra e tyre, nuk mund të konsiderohen të tilla vetëm për organin shtetëror të ngarkuar nga ligji për administrimin e zgjedhjeve, por për të gjithë aktorët dhe faktorët me rol të drejtpërdrejtë apo jo në proces. Kjo veprimtari institucionale e shtrirë në një periudhë shtatë mujore, jashtë periudhës zgjedhore, , jo vetëm do t'i shërbejë përmirësimit të punës institucionale në të ardhmen, por gjithashtu realizoi një qasje tjetër mes KQZ, si institucion lider i ngarkuar për administrimin dhe realizimin e procesit, dhe të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tjerë me rol të drejtpërdrejtë apo jo në procesin zgjedhor.

Iniciativa institucionale e KQZ-së për trajtimin e problematikave apo mosarritjeve të dëshmuara gjatë procesit zgjedhor të 23 qershorit 2013, disa prej tyre të dëshmuara edhe në proceset zgjedhore pararendëse, nuk do të ishte e mundur të jetësohej pa mbështetjen dhe asistencën në vijimësi të partnerëve ndërkombëtarë, Prezenca e OSBE-së, Zyra e Këshillit të Europës, UN Women etj.



## **B.1. Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: “Ushtrimi i të drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, solli në një Tryezë të përbashkët përfaqësues institucionesh, të partive politike, organizatash ndërkombëtare dhe grupe të interesit, të cilët kanë përgjegjësi, bashkëpunojnë apo kontribuojnë në mundësimin dhe lehtësimin e personave me aftësi të kufizuar për të ushtruar të drejtën e votës në një proces zgjedhor.

Të pranishmit në tryezë analizuan eksperiencën e institucioneve dhe organizatave jo-qeveritare që kanë kontribuar, monitoruar apo që përfaqësojnë grupet e interesit për personat me aftësi të kufizuar në raport me ushtrimin e të drejtës për të votuar.

Kjo tryezë e moderuar në 2 seanca, kishte për qëllim i. shprehjen e interesit dhe qëndrimet e të gjithë aktorëve dhe faktorëve që ndikojnë në marrjen e përgjegjësive të përbashkëta; dhe ii. identifikimin e mënyrave, mjeteve dhe teknikave për të garantuar në të ardhmen e afërt kushtet për ushtrimin e lirë të së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar.

Në mënyrë të përmbledhur dhe në përputhje me detyrimin kushtetues dhe ligjor, për garantimin e ushtrimit të së drejtës së votës, ky dokument rendit një sërë rekomandimesh.

Më konkretisht, këto rekomandime konsistojnë në pikat e mëposhtme:

- Është e domosdoshme që Kodi Zgjedhor të përforcojë dispozitat të cilat i referohen masave që duhet të merren për garantimin e ushtrimit të së drejtës së votës për personat që nuk mund të votojnë vet;
- Kjo vëmendje duhet të fillojë me detyrimin për ngritjen e një Komiteti “Ad-hoc”, me përfaqësues të të gjitha institucioneve përgjegjëse dhe grupeve të interesit – në mënyrë që zgjidhja e çdo problemi që lidhet me ushtrimin e të drejtës së votës nga çdo kategori e personave me aftësi të kufizuar dhe monitorimi, realizimi dhe çdo sukses i këtij process të jetë një sfidë, angazhim dhe vullnet i përbashkët i të gjitha institucioneve përgjegjëse. Periudha e ngritjes dhe kohëzgjatjes së këtij Komiteti mund të ketë disa opsione: i. me fillimin e reformës zgjedhore në Kuvend, ii. me shpalljen e Dekretit për datën e zgjedhjeve.
- Kodi Zgjedhor duhet të reflektojë ndryshime dhe përmirësime ligjore të cilat duhet jenë në frymën e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kodi Zgjedhor duhet të përcaktojë sanksione ndaj pushtetit vendor, në rast të mosrespektimit të ligjit dhe detyrimeve për garantimin e kushteve për ushtrimin e të drejtës së votës nga Personat me Aftësi të Kufizuara;
- Kodi zgjedhor duhet ta përcaktojë si dispozitë urdhëruese dhe jo si zgjidhje alternative detyrimin e pushtetit vendor për të garantuar infrastrukturën ndihmëse në çdo qendër votimi ku janë të regjistruar zgjedhës që nuk mund të votojnë vet. Ky detyrim duhet të monitorohet nga KQZ, e cila duhet të ketë në dispozicion mekanizma ligjorë, të cilat i japin mundësi të marrë masa administrative ndaj drejtuesve të pushtetit vendor, të cilët nuk i përgjigjen kërkesave të ligjit dhe autoritetit monitorues;
- Kodi Zgjedhor duhet të shprehet për të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuar



intelektuale (PAKI), i cili vazhdon të mbetet një problem i lënë në heshtje dhe që në fakt nuk ka patur raste të kufizimit. Në këtë këndvështrim, Kodi Zgjedhor duhet të specifikojë mënyrat dhe nevojat për përshtatshmëri duke ju referuar nocioneve/llojit të paaftësisë dhe jo të përgjithësuar;

- Për më tepër, Kodi Zgjedhor nuk duhet të përcaktojë procedura të cilat lidhen me ndarje të përgjegjësiwe institucionale për përgatitje të listave të personave që nuk mund të votojnë vet, pasi ky fakt, jo vetëm që shpërndan dhe më shumti shmang përgjegjësitë institucionale, por lë hapësirë edhe për abuzime procedurale. Në përmirësim të kësaj dispozite, Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë që në propozimet dhe vendimmarrjen e institucioneve publike (sidomos pushtetit vendor) të cilat kanë përgjegjësi problematikën e personave me aftësi të kufizuara, të ketë edhe përfaqësim të shoqatave të PAK;
- Kuvendi i Shqipërisë duhet që të marrë në konsideratë dhe të bëjë pjesë të procesit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor edhe përfaqësuesit e Grupit të Interesit të personave me aftësi të kufizuara, të cilët, për shkak të përvojës dhe ekspertizës mund të ofrojnë zgjidhje ligjore dhe teknike shumë më efektive;
- Përtej rekomandime për ndryshime të legjislacionit zgjedhor, i cili është vetëm një aspekt i zgjidhjes së problemit, Grupet e Interesit mund t'i drejtohen me një letër të hapur Qeverisë Shqiptare për të filluar një projekt monitorimi në të gjithë vendin për krijimin e infrastrukturës ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha objektet të cilat ofrojnë shërbime publike dhe sociale.

KQZ, në zbatim të dispozitave ligjore ekzistuese, ka filluar bashkëpunimin me të gjitha grupet e interesit, në mënyrë për të përcaktuar jo vetëm prioritet kryesore për këtë target grup zgjedhësish, për zgjedhjet për Organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, por dhe për të marrë prej tyre informacionet dhe mbështetjen e mundshme, në realizimin e qëllimit të përbashkët.

## **B.2 Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: "Shanset e barabarta dhe respektimi i kuotës gjinore elektorale".**

Në datën 24.01.2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me mbështetjen e UN EOMEN (United Nations for Gender Equality and the Empowerment of Women), organizoi një Tryezë të përbashkët me fokus rritjen e pjesëmarrjes së grave në organet e zgjedhura dhe në komisionet zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta.

Temat e diskutimit në këtë Tryezë u fokusuan tek barazia gjinore në Kodin Zgjedhor dhe standardet ndërkombëtare, monitorimi i praktikës së KQZ-së në pjesëmarrjen e grave ditën e zgjedhjeve, përfshirja e gruas në administratën zgjedhore të fundit për Kuvend të 23 qershorit 2013, kuotat gjinore në listat e kandidatëve (fokusuara tek masat e veçanta për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje) dhe metodologjitë e monitorimit të pjesëmarrjes dhe statistikat e nxjerra nga KQZ të krahasuara në vitet zgjedhore.

Në përfundim të referimeve dhe diskutimeve, Tryeza Teknike doli me konkluzione dhe rekomandime, të cilat besojmë se do të jenë të vlefshme në përmirësimin e përfaqësimit dhe



përfshirjes së gruas në proceset e ardhshme zgjedhore dhe në organet vendimmarrëse.

Të drejtat e barabarta të grave dhe burrave janë të sanksionuara në aktin themeltar të Republikës së Shqipërisë - Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Neni 18 i saj garanton barazi të grave dhe burrave përpara ligjit. Shqipëria ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave më 1993 dhe Protokollin Fakultativ përkatës më 2003.

Legjislacioni dhe politikat për gjininë në Shqipëri pasqyrojnë gjithashtu procesin e vazhdueshëm të vendit drejt integritimit në Bashkimin Europian, i nisur zyrtarisht përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit më 2006.

Meqenëse barazia është një nga parimet parësore të BE-së, detyrimet e Shqipërisë për harmonizim gjenden në pesë fushat e politikave të shprehura në Strategjinë e BE-së për barazi mes grave dhe burrave, 2010-2015.

Barazia mes grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës private dhe publike përvijohet më tej në legjislacion, si në ligjin nr. 9970 "Për Barazinë gjinore në shoqëri", i cili ka hyrë në fuqi më 2008. Synimi i këtij ligji është: i) të sigurojë mbrojtje efektive ndaj diskriminimit të lidhur me gjininë; ii) të përcaktojë masat për të garantuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, në mënyrë që të eliminohet diskriminimi i lidhur me gjininë; dhe iii) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore në të gjitha nivelet për hartimin dhe zbatimin e akteve normative dhe politikave në përkrahje të barazisë gjinore.

Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" synon harmonizimin e gjinisë, si strategji për arritjen e barazisë gjinore, përmes integritimit të një pikëpamjeje gjinore në të gjitha proceset ligjbërëse, politikëbërëse, zbatuese dhe monitoruese. Ky ligj, ndërmjet të tjerash, prezanton masa të përkohshme specifike në pozicionet e vendimmarrjes politike dhe publike (për të garantuar të paktën 30% pjesëmarrje të gjinisë më pak të përfaqësuar) si dhe masa të posaçme për të mbledhur statistika gjinore.

Në analizë të tyre tryeza arriti në disa përfundime dhe rekomandime.

- Vendosjen në kuadrin e parimeve të përgjithshme lidhjen që ka një ligj i rëndësishëm siç është Kodi Zgjedhor me çështjen e barazisë gjinore.
- Respektimin e kuotës gjinore në përbërjen e KQZ-së dhe KZAZ-së duke garantuar që edhe në rast zëvendësimi, anëtari që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar do të jetë po i kësaj gjinie.
- Vendosjen e kuotës gjinore në nivelin e KQV-së dhe GNV-së si detyrim ligjor dhe ruajtjen e saj gjatë gjithë veprimtarisë së KQV-së.
- Detyrimin ligjor të KQZ-së që të përfshijë në Buletin e Zgjedhjeve të dhëna statistikore për pjesëmarrjen në zgjedhje të gjinisë më pak të përfaqësuar dhe rezultatet zgjedhore për kandidatët nga kjo gjini. KQZ-ja duhet të publikojë gjithashtu të dhëna statistikore për





çështjet gjinore për përbërjen e organeve të zgjedhura ose të emëruar nga Kuvendi, duke përditësuar këto të dhëna ndër vite.

- Evidentimin në listën e zgjedhësve, të cilën e përdorë KQV, të zgjedhësve sipas gjinisë, për përpunimin e të dhënave dhe nxjerrjen e statistikave të sakta zyrtare. Evidentimi i gjinisë bëhet vetëm për qëllim të mbledhjes së të dhënave statistikore.
- Vendosi dhe zbatimin e kuotës gjinore në mënyrë të plotë në përbërjen e Kuvendit dhe të këshillave të bashkisë ose të komunës duke përcaktuar renditjen e kandidatëve në mënyrë alternative sipas gjinisë. Ky formulim është i qartë dhe është i prerë dhe garanton përbërjen të paktën 30 përqind të këtyre organeve nga gjinia më pak e përfaqësuar.
- Sanksionimin në ligj të refuzimit të regjistrimit të listave shumëmemërore në rast të mosrespektimit të gjinisë në zgjedhjet për Kuvendin. Konstatimin nga KQZ të pavlefshmërisë absolute të cdo mandati të fituar në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, në rast se subjekti nuk ka respektuar kriterin e gjinisë në listat shumëmemërore.
- T'i jepet përfundimisht fund "lojës" në kurriz të ligjit që po zhvillohet aktualisht në Shqipëri nga partitë politike me dorëheqjet e stimuluar të kandidateve gra në listat shumëmemërore. Garantimin se sa herë krijohet vakancë plotësimi i saj bëhet nga kandidate femra të listave shumëmemërore, dhe në rastet e shterimit të listave të kandidateve femrave plotësimi të bëhet nga kandidatë femra të partive të tjera branda koalicionit.
- Garantimin e zbatimit të kuotës gjinore në përbërjen e organeve të zgjedhura duke parashikuar në to edhe mekanizmat që garantojnë zbatimin e saj.

Gjithashtu tryeza propozoi dhe mundësinë e rishikimit të sistemit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore duke dhënë disa rekomandime:

- 1.** Votimi për organet e qeverisjes vendore të bëhet sipas sistemit proporcional. Shkaqet që çuan Ligjvënësin drejt vendimit për sistemin proporcional në zgjedhjet e përgjithshme janë po aq të vlefshme edhe për zgjedhjet vendore. Votuesit të votojnë për subjektin zgjedhor, i cili paraprakisht ka rregjistruar një listë shumëmemërore të kandidatëve. Votuesit në ditën e zgjedhjeve për organet bazë të njësisë vendore të jenë të pajisur vetëm me një fletë votimi, me të cilën të votohet si për kryetarin, ashtu dhe për këshillin.
- 2.** Individit që është regjistruar me numrin 1 në listën shumëmemërore të subjektit zgjedhor është edhe kandidati për kryetar të bashkisë ose të komunës. Pjesa tjetër e individëve të listës janë kandidatët për këshillin e bashkisë ose të komunës.
- 3.** Në listën shumëmemërore, në rast se numri 1 i përket gjinisë mashkullore, duhet të pasohet në mënyrë të njëasnjëshme me dy kandidate nga gjinia femërore. Kështu në rast vakance të kryetarit, plotësimi bëhet nga kandidatët e gjinisë femërore.



4. Ne vlerësojmë se ky propozim nuk ka mospërputhje me dispozitat e Kushtetutës, por kërkon ndryshime themelore në Kodin Zgjedhor dhe ndryshime teknike në një sërë dispozitash të tjera me natyrë teknike si psh fleta e votimit, procedura e votimit, nxjerrja e rezultatit, tabelimi, etj.

### **B.3 Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: "Fushata zgjedhore dhe media, sfida për të ardhmen"**

**Në datën 03.03.2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri** me përfaqësues të partive politike medias, të anëtarëve të Bordit të Monitorimit të Medias, të pedagogëve nga Departamenti i Gazetarisë UT, si dhe përfaqësues të disa organizatave ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri, **ka zhvilluar Tryezën Teknike me temë "Fushata zgjedhore dhe media, sfida për të ardhmen"**, e cila pati një rëndësi të madhe. Nga të gjithë pjesëmarrësit u pranua se në Shqipëri media si pushteti i katërt gjatë proceseve zgjedhore ka arritur disa standarte të larta dhe të gjithë pranuar dhe nga partnerët ndërkombëtar.

Nisur nga fakti se në Shqipëri operojnë një numër i madh operatorë televizivë kombëtar, lokalë, kabllor, radio, gazeta të shkruara dhe sidomos media e re me bazë të gjerë përdorimi ajo elektronike, është një platformë e mirë për informimin dhe edukimin qytetar, në lidhje me fushatat zgjedhore, programet dhe misionet e çdo subjekti zgjedhor që merr pjesë në zgjedhje. Tashmë në Shqipëri lira e shprehjes dhe e medias si një nga parimet e rëndësishme kushtetuese, është e konfirmuar. Nga një proces zgjedhor në tjetrin konstatohen arritje pozitive jo vetëm në konsolidimin e rregullime ligjore por edhe në rritjen e profesionalizmit, ndjenjën e përgjegjësisë së medias në raport me pasqyrimin e proceseve zgjedhore, edukimin qytetar dhe institucionet e administrimit të zgjedhjeve.

Në zgjedhjet e fundit shumica e mediave qendrore të cilat u monitoruan rezultuan në përgjithësi, të balancuara në pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive politike kryesore.

Por sigurisht përveç konsolidimit të këtyre arritjeve tryeza konstatoi dhe problematika, jo vetëm ato të paraqitura në raportet e OSBE/ODIHR, por dhe problematika të konstatuara nga dy proceset e fundit zgjedhore të dala nga analizat e anëtarëve të BMM, të ekspertëve të medias, dhe në çështje të tjera që lidhen me aspektin, administrativ dhe praktik të këtyre marrëdhënieve.

Në analizë të tyre tryeza arriti në disa përfundime dhe rekomandime.

- Nisur nga fakti se neni 84, pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe vendimi i KQZ-së në lidhje me pasqyrimin e fushatës zgjedhore bazuar në materialet e përgatitura nga subjektet zgjedhore nuk u interpretua drejtë dhe shkaktoi debat, nga një pjesë e aktorëve pjesëmarrës në zgjedhje, kjo dispozitë duhet të rishikohet duke shprehur në mënyrë të qartë të drejtën e medias për të zgjedhur nëse prodhon vetë lajme/kronika zgjedhore ose pranon të gatshme nga subjektet elektorale. Tryeza ishte e një mendje për përmirësimin e Kodit Zgjedhor për të përcaktuar qartë se çdo material i lidhur me fushatën, i përgatitur



nga subjektet zgjedhore kryesisht duhet të identifikohet si material propagandistik i cili të transmetohet si pjesë e reklamës politike.

- Ekzistenca e dispozitave penale në Kodin Penal (2012, neni 120) që dënon me gjobë nga 50 mijë deri në 3 milion lekë personat që përhapin thënie apo informacione të rreme, rezultoi se përbën një shqetësim në fushatën elektorale sepse kufizon lirinë e shprehjes.
- Tryeza rekomandoi ndryshimet ligjore për shfuqizimin e këtij neni në kodin penal duke mos u klasifikuar më shpifja si vepër penale kundër moralit dhe dinjitetit, por të rregullohet si marrëdhënie civile nga Kodi Civil.
- Tryeza konstatoi rishikimin e mënyrës së emërimit të anëtarëve të BMM duke e bërë procesin më transparent, më gjithëpërfshirës dhe më profesional.
- Tryeza propozoi disa variante, midis të cilëve varianti që në zgjedhjen e anëtarëve të BMM të zbatohet e njëjta procedurë shorti si në rastin e ekspertëve kontabël. Një numër subjektesh të medias, media publike e private, Universiteti i Tiranës (departamenti i gazetarisë), OJF që operojnë në sektorin e medias etj mund të propozojnë emra, të cilët më pas zgjidhen nëpërmjet procedurës së shortit në KQZ, si anëtar të BMM.
- Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë kriteret të qarta për emërimin e Anëtarëve të BMM.
- Kodi Zgjedhor parashikon vendosjen e gjobës ndaj operatorëve audiovizivë si masë administrative në rast të shkeljeve të dispozitave të tij. Duke qenë se masa e gjobës e parashikuar nga Kodi Zgjedhor, konsiderohet relativisht e lartë për kapacitete ekonomike të operatorëve, BMM stepet për të propozuar para KQZ-së masën administrative me gjobë. Rekomandohet rishikimi i masës së gjobës në rastet e shkeljes, në mënyrë që ajo të bëhet më efektive dhe e zbatueshme.
- Tryeza rekomandoi përcaktimin e detyrimit ligjor për Autoritetin e Mediave Audiovizive për të mundësuar BMM të monitorojë të gjitha mediat kombëtare dhe lokale në të gjithë territorin, duke evituar disbalancimin dhe standardet e dyfishta në monitorime dhe raportime në dy zgjedhjet e fundit. Kjo formë eviton rastet e konstatuara kur BMM nuk ka arritur të monitorojë media në qarqe të caktuara për pamundësi teknike ose mungesa në personel.
- Rezulton se partitë politike e fillojnë fushatën zgjedhore shumë kohë më parë se përcaktimi ligjor 30 ditë para datës së zgjedhjeve. Në mënyrë që media të mos lejohet të pasqyrojë aktivitetet e partive politike në rastet kur partitë dhe subjektet elektorale e nisin fushatën zgjedhore kohë përpara fillimit të periudhës zgjedhore, procesi monitorues nëpërmjet Bordit të Monitorimit të Medias të përfshijë një periudhë më të gjatë se periudha zgjedhore.
- Tryeza e konsideroi të drejtë kritikën dhe sugjerimin për detyrimin me ligj të mediave për zbatimin e kriterëve të informimit të kandidatëve, sipas gjinisë, si dhe për ndryshimin e praktikës së BMM, për përfshirjen e komponentit gjinor në metodologjinë e tij për monitorimin e medias.
- Tryeza rekomandoi detyrimin ligjor të partive politike, të cilat brenda kohës që u vihet falas nga operatorët audiovizive, gjysmën /30% të saj, ta vënë në dispozicion për



kandidatet femra.

- Përcaktimin ligjor për vendosjen e kohës falas në dispozicion të kandidatëve të mbështetur nga zgjedhësit në Radio Televizionin Publikë për të shmangur standardet e dyfishta ndërmjet subjekteve zgjedhore në zgjedhje.
- Tryeza rekomandoi përcaktimin ligjor të detyrimit të medias për të transmetuar informacion profesional për personat me aftësi të kufizuar, sidomos për grupet që nuk shikojnë/dëgjojnë.
- Tryeza rekomandoi si domosdoshmëri për rritjen e profesionalizmit etikës dhe performancës për të gjithë aktorët pjesëmarrës në pasqyrimin në media të fushatës zgjedhore zhvillimin e trajnimeve. Trajnimi duhet të përfshijë krahas anëtarëve të BBM dhe stafit teknik në ndihmë të tij, por dhe gazetarët, redaktorët dhe punonjësit e medias që merren direkt me fushatat zgjedhore, në mënyrë që ata të njohin nga afër dhe në detaje sistemin zgjedhor, sistemin administrues dhe detaje të tjera që lidhen me integritetin e procesit dhe informimin publik.

#### **B.4. Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: "Praktikat më të mira dhe platformat e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë".**

Në datën 31.03.2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, me prezencën e përfaqësuesve të partive politike, organizoi tryezën teknike konsultative "Praktikat më të mira dhe Platformat e Trajnimit të Komisionerëve Zgjedhore".

Trajnimi i komisionerëve zgjedhorë, është një nga aspektet më të rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, pasi garanton profesionalizmin e tyre, respektimin prej tyre me korrektësi të përcaktimeve dhe procedurave ligjore, dhe ka impakt të drejtpërdrejtë në respektimin dhe leximin drejt të vullnetit të shprehur nga çdo votues.

KQZ ka evidentuar, sikundër dhe në raportet e organizmave ndërkombëtarë apo dhe organizatave vendase që monitorojnë procesin zgjedhor është pasqyruar, se ende procesi zgjedhor çënohet nga mungesa e profesionalizmit të komisionerëve zgjedhorë, mungesë e cila buron nga mosmarrja e trajnimit zyrtar. Një pjesë e konsiderueshme e komisionerëve të angazhuar në procese zgjedhore nuk kanë pasur trajnimin e certifikuar profesional dhe se praktika e zëvendësimit të komisionerëve edhe në momentet e fundit, ose propozimet/emërimet në tejkallim të afateve ligjore, vijon të mbeten një problem shqetësues i cili çënon jo vetëm standardet e procesit por ul djeshëm efektivitetin e trajnimeve të organizuara nga KQZ.

Për çdo proces zgjedhor KQZ angazhohet në bazë të një plani të mirë studiuar për trajnimin e të gjithë komisionerëve zgjedhorë të çdo niveli duke angazhuar, mbi bazën e një procesi të hapur konkurimi, një numër të madh trajnuesish, të cilët pasi kanë marrë trajnimin e duhur, vijnë sipas programit të miratuar dhe bërë publik, trajnimin e komisionerëve në të gjithë territorin e vendit.

Pavarësisht angazhimit maksimal të KQZ-së, lirimet/emërimet e komisionerëve në vijimësi, edhe



në ditën e zgjedhjeve, emërimet në tejkalim të skajshëm të afatit ligjor të komisionerëve të nivelit të tretë, mosmarrja pjesë në trajnimet e organizuara nga KQZ, janë tipologjitë e problemeve që kanë cënuar ndjeshëm efektivitetin e trajnimeve. Fakt tjetër që nga procesi në proces vazhdon të mbetet evident, është trajnimi paralel i komisionerëve nga partitë politike, dhe në këtë "dualitet" trajnimesh të ofruara, komisionerët janë më të prirur për pjesëmarrje në trajnimet e organizuara nga partitë, kjo ndoshta edhe për të dëshmuar përkushtim ndaj kauzës politike. Për shkak të këtij trajnimi paralel, evidentohet një pjesëmarrje jo e kënaqshme e komisionerëve të nivelit të tretë në seancat e trajnimit, pavarësisht se KQZ bën përpjekje maksimale që çdo komisioner të trajnohet, duke ofruar trajnim edhe jashtë kalendarit të planifikuar.

KQZ, duke synuar gjetjen e rrugëve dhe mënyrave për rritjen e efikasitetit të trajnimeve të komisionerëve zgjedhorë, në tryezën teknike me temë "Praktikat më të mira të platformave të trajnimit të komisionerëve zgjedhorë", bëri pjesë të diskutimeve problematikat që çënojnë platformën e trajnimit, si dhe prezantoi përvojën e modeleve të trajnimit zgjedhor në dy vendet e tjera me realitete të ngjashme, Gjeorgjia dhe Moldavia, si dhe gjetjet e mundshme të këtyre përvojave të suksesshme për aplikim në rastin shqiptar. Tryeza u organizua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve kryesorë të partive politike, organizatave që veprojnë në çështjet zgjedhore, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, grupeve të interesit, trajnues të KQZ, si dhe vetë administratën e institucionit. Debatimi mbi platformën e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë në Shqipëri u përqendrua kryesisht në përvojën krahasuese të dy vendeve të tjera, Gjeorgji dhe Moldavi, si dhe probleme teknike të statutit të institucionit trajtues, financimit, emërimit, përgjegjësisë dhe raportit me aktorët politikë dhe konkurrues në zgjedhje. Në funksion të analizës më të plotë krahasimore u sollën edhe modele pozitive të standardeve të konsoliduara zgjedhore, si ishte rasti i Zvicrës.

Vlerësimet dhe gjetjet kryesore të tryezës ishin:

- Në unanimitet nga pjesëmarrësit u vlerësua nevoja që e gjithë trupa e administrimit zgjedhor duhet të dëshmojë më shumë profesionalizëm, pasi profesionalizmi do të thotë më shumë pavarësi në ushtrimin e detyrës, dhe profesionalizmi dhe pavarësia në ushtrimin e detyrës janë kollonat bazë të rritjes së besueshmërisë publike në procesin zgjedhor, mënyrën e administrimit të tij. Në këtë kontekst, u evidentua nevoja e krijimit të një institucioni të trajnimit të komisionerëve dhe të gjithë stafeve administrative që lidhen me zgjedhjet, nëpërmjet një programi efektiv dhe afatgjatë trajnimi, si parakusht për rritjen profesionale të të gjithë personave që merren me përgatitjen dhe administrimin zgjedhor.
- Në vlerësim të rëndësisë të trajnimit dhe certifikimit të njohurive të komisionerëve zgjedhorë, dobësive që dëshmon platforma e trajnimit që aplikohet aktualisht, domosdoshmërisë dhe pritshmërive për përmirësim të saj, tryeza diskutoi për format më optimale për ndryshim të saj, për pika takimi midis modeleve të sjella nga dy vendet e tjera dhe Shqipërisë, në kontekst të realitetit zgjedhor shqiptar. Përvoja e sjellë nga dy prej vendeve me problematika të njëjta me Shqipërinë gjatë tranzicionit, Gjeorgjia dhe Moldavia, dëshmoi suksesin e praktikës së trajnimit përmes një Qendre Trajnimi.



- Në raport me konceptin e gjerë institucional të trajnimit të të gjitha grupeve të përfshira në zgjedhje, të krijimit të një sistemi të mirë-trajtuar përmes të cilit të burojnë të gjitha përzgjedhjet dhe vendimet që lidhen me tre nivelet e komisioneve, vëzhguesit dhe hallkat e tjera administrative, si dhe të përvojave të njohura në vende të tjera, - Kodi Zgjedhor ofron një bazë ligjore jo të plotë, por mjaftueshme për të të mundësuar edhe aktualisht fillimin e projektit për trajnimin gjithëpërfshirës në periudhën parazgjedhore.

- Për ngritjen, funksionimin dhe jetësimin praktik të Qendrës së Trajnimeve në Shqipëri, krahas praktikave të suksesit të Gjeorgjisë dhe Moldavisë, tryeza vlerësoi se referim thelbësor mbeten praktikat më të mira trajnuese dhe zgjedhore të njohura përmes dokumenteve ndërkombëtare të ODIHR/OSBE dhe Këshillit të Evropës, - si burim referues juridik dhe administrativ, si praktikë e çertifikuar e modeleve për të cilat realiteti shqiptar dëshmon domosdoshmëri për tu implementuar, dhe dëshmohet pritshmëri dhe vullnet për t'i zbatuar.

Duke vlerësuar rëndësinë e edukimit zgjedhor të shtetasve, tryeza vlerësoi se fokusi i punës së institucionit të trajnimit për çështjet zgjedhore duhet të zgjerohet, duke përfshirë edhe aktivitetet e promovimit të demokracisë, të formimit demokratik, të dhënies së njohurive bazë mbi demokracinë dhe zgjedhjet për të gjitha grupimet dhe individët e interesuar.

Ekspertët e ftuar në tryezë sugjeruan që duke marrë elementët pozitiv të dy modeleve të tjera, (Gjeorgji dhe Moldavi) të synohet krijimi i një Qendre trajnimi dhe edukimi zgjedhor me status ligjor dhe administrativ të pavarur. Deri në realizimin integral të projektit, ekspertët sugjeruan një fazë kalimtare, bazuar në kuadrin aktual ligjor, dhe sigurisht me mbështetje të partive politike, për të krijuar përgjatë kësaj faze besimin publik tek efikasiteti i trajnimit të organizuar, të hapur dhe të përfshirës.

Tryeza (organizatorët, institucionet mbështetëse dhe ekspertët) sugjeruan ngritjen e një grupi Ad hoc pranë KQZ dhe me pjesëmarrjen e organizatave ndërkombëtare mbështetëse, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile që merren me zgjedhjet, të krijojnë një projekt plan për gjithë problematikën e Qendrës dhe të sugjerojnë masat konkrete administrative për jetësimin e saj.

Pas mundësisht të konsensusit të gjerë dhe ndryshimeve të nevojshme ligjore që jetësojnë krijimin e Qendrës së Trajnimit (brenda KQZ ose jashtë tij) mund të operohet me një plan veprimi afatgjatë. Deri atëherë, u vlerësua nevoja e vullnetit politik mbështetës nga partitë politike, mendim që u mbështet nga ekspertët, KQZ dhe pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në tryezë.

### **B.5. Organizimi dhe zhvillimi i Tryezës Teknike: "Financimi i partive politike gjatë fushatës zgjedhore".**

Në tryezën e rrumbullakët teknike "**Financimi i partive politike gjatë fushatës zgjedhore**" organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më datë 14.05.2014, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ekspertëve të ODHIR-it, prezent përfaqësuesit e partive politike, pjesëmarrësit, ndanë mendimin se trajtimi i kësaj çështje është shumë i rëndësishëm si element kyç në luftën kundër korrupsionit, bënë propozime konkrete për përmirësime në të ardhmen dhe konstatuan se:



- Gjatë viteve të fundit, vëmendja e publikut të gjerë për çështjet e financimit të partive politike është rritur ndjeshëm,
- Media, shoqëria civile, akademikët dhe qytetarët janë bërë më aktivë në kërkesën për të rritur monitorimin e partive politike në fushën e financave,
- Ndonëse kuadri ligjor për financimin e partive politike është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë këtyre viteve të fundit, zbatimi i duhur i tij ende çalon,
- Nga monitorimi bërë nga një organizatë e shoqërisë civile ka dalë që shpenzimet de facto të partive politike shkojnë në dy deri në katërfish të asaj që ato deklarojnë zyrtarisht,
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të kryejë hetime proaktive për të verifikuar llogaritë financiare të partive politike,
- Duhet të vendosen kanale komunikimi me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe duhet të realizohet një bashkëpunim i qartë mes KQZ-së dhe organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë zgjedhjet,
- Gjatë një periudhe afërsisht 23-vjeçare, kuadri rregullator shqiptar për financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore i është nënshtruar një transformimi tërësor. Nevojiten reforma të mëtejshme dhe kjo duhet realizuar së pari përmes një konsensus të gjerë politik ndërpartiak.

Në analizë të gjetjeve të sipërpërmenura tryeza arriti në disa përfundime dhe rekomandime.

**1.** Publikimi i informacioneve financiare nga vetë partitë politike duhet të rregullohet nga dispozita ligjore të posaçme dhe të monitorohet nga KQZ-ja.

Partitë politike në Shqipëri nuk vënë në dispozicion të publikut, anëtarëve, apo votuesve të dhënat e tyre financiare. Një gjë e tillë shihet si treguesi kryesor i mungesës së përgjegjësisë dhe transparencës.

Nevojitet një dispozitë e posaçme ligjore për të rregulluar publikimin e këtyre informacioneve nga vetë partitë politike.

Për këtë qëllim, duhet të ndryshohet neni 23 i ligjit "Për partitë politike".

**2.** Duhet të përfshihen dispozita të qarta në ligj për të bërë ndarjen ndërmjet formatit të raportimit vjetor financiar për partitë nga raportimi i financave të fushatave zgjedhore gjatë viteve zgjedhore. Ligji duhet të parashikojë afate të prera për dorëzimin e raporteve në KQZ nga partitë politike si dhe detyrimin e KQZ-së për t'i publikuar këto raporte brenda afateve të mirëpërcaktuara. Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor duhet të përmbajë një dispozitë mbi "raportimin" e financimit të fushatës zgjedhore. Neni 23/4 i ligjit "Për partitë politike" i referohet raportimit të financave të fushatës zgjedhore, por kjo nuk është ende e parashikuar në Kodin Zgjedhor.

Për këtë qëllim, paragrafi 4 i nenit 23 të ligjit "Për partitë Politike" duhet ndryshuar.

**3.** Format i aktual i auditimit i përcaktuar me ligj është tepër i detajuar dhe e bën voluminoze punën e auditimit. Duhet kërkuar një formë "më e zhveshur" e bilanceve, që përmban atë çka është e rëndësishme, si për shembull të ardhurat, shpenzimet, huatë, etj.



Specialistët e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA) rekomandojnë që në ligj të përmendet standardi kontabël i njohur si "EVR" (Expenditure Verification Report). Ky standard duhet të vendoset në ligj si rregull i përgjithshëm dhe KQZ-së, në bashkëpunim me IEKA-n, duhet t'i jepet kompetenca të miratojë rregullat dhe rregulloret teknike që plotësojnë kuadrin ligjor.

Për këtë qëllim, paragrafi 5 i nenit 23 të ligjit "Për Partitë Politike" dhe neni 91 i Kodit Zgjedhor duhen ndryshuar.

**4.** Për vitin 2012, KQZ-ja ishte e detyruar të bënte auditimin e 123 partive politike të regjistruara në Regjistrin e Partive Politike në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Raportet e Auditimit u dorëzuan nga 13 parti politike. 21 parti politike nuk janë kontaktuar nga KQZ-ja, sepse ato nuk i kanë dhënë një adresë të saktë KQZ-së. Për 89 partitë e tjera politike, nuk ka asnjë informacion rreth financave të tyre.

Ligji "Për Partitë Politike" duhet të ofrojë një zgjidhje ligjore për këto rrethana. Partitë duhet të jenë të detyruara me ligj që, nëse ndryshojnë adresë, duhet të njoftojnë zyrtarisht KQZ-në brenda një afati të caktuar, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vetë partia apo nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Nëse një detyrim i tillë nuk respektohet, ligji duhet të ofrojë një mekanizëm dhe procedurë për t'u ndjekur (si njoftimet publike), si dhe sanksione proporcionale për raste të tilla.

Për këtë qëllim, neni 11 i Ligjit "Për Partitë Politike" duhet ndryshuar.

**5.** Raportet financiare i dorëzohen KQZ-së dhe publikohen nga kjo e fundit në periudha të ndryshme kohore. Ekziston një boshllëk ligjor në lidhje me afatin e dorëzimit, sepse ligji "Për Partitë Politike" nuk përcakton datën e raportimit.

Për këtë qëllim, neni 23 i ligjit "Për Partitë Politike" duhet ndryshuar.

**6.** Ligji "Për Partitë Politike" përcakton që kontrolli i financave të partive duhet bërë çdo vit për secilën nga mbi 140 partitë të regjistruara në Gjykatë. Por rreth 50% e partive politike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Tiranë nuk kanë marrë pjesë në katër garat e fundit zgjedhore. Ligji duhet të ofrojë një mekanizëm të efektshëm për kontrollin e financave të partive në kushtet e kufizimeve në buxhet dhe burime njerëzore. Ligji duhet të përcaktojë shprehimisht prioritetet për kontrollin e financimit të partive. Prioritet mund të jenë për shëmbëll kontrolli vjetor për ato parti që përfitojnë nga fondet publike.

Për këtë qëllim duhet shtuar një nen i ri në ligjin "Për Partitë Politike".

**7.** Neni 23/1 i ligjit "Për partitë politike" parashikon që lista e personave që dhurojnë më shumë se 100 000 lekë (afërsisht 720 EUR) duhet të bëhet publike. Neni 90, paragrafi 2 i Kodit Zgjedhor parashikon që fondet jopublike me vlerë më të madhe se 100 000 lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor dhe që përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim.

Ky prag është shumë i lartë dhe lë shteg që të pengohet bërja e transparencës së burimeve të financimit nën këtë shumë.





Sipas Open Data Albania: Fushata zgjedhore 2009: 59% e vlerës së 'Donacioneve' ka si burim donatorët të shumave nën 100 mijë lekë. Në vlerë absolute, kjo është 64 435 904 lekë. Pjesa tjetër, pra 41%, janë donatorë të shumave mbi 100 mijë lekë. Fushata Zgjedhore 2011: 78,8% e vlerës së 'Donacioneve' janë nga donatorë të shumave nën 100 000 lekë, që nuk janë objekt i nenit 90 të Kodit Zgjedhor. Fushata Zgjedhore 2013: 30% e vlerës së 'Donacioneve' janë donacione me vlerë nën 100 000 lekë.

Ndaj, këto dispozita duhen ndryshuar me qëllim që të ulet ky prag (deri në 150 euro, sa paga minimale), në mënyrë që të bëhen publike të gjitha dhurimet që i bëhen partive politike

**8.** Neni 88 i Kodit Zgjedhor duhet të parashikojë në mënyrë më rigorozë moslejimin e përdorimit të burimeve publike për mbështetjen e subjekteve zgjedhore. KQZ-ja duhet të jetë kompetente për miratimin e të gjithë mekanizmave të nevojshëm për të parandaluar abuzimin me burimet shtetërore nga partitë politike. Nëse kjo ndodh, KQZ-ja duhet të reagojë menjëherë duke marrë të gjitha masat dhe vendosur gjokat e nevojshme që kjo të mos përsëritet në ditët në vazhdim të fushatës zgjedhore.

Për këtë qëllim, neni 88 i Kodit Zgjedhor duhet ndryshuar.

**9.** Neni 89 i Kodit Zgjedhor parashikon që ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksioner i tij, nëse ai/ajo ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë; ushtron veprimtari në fushën e medias; ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; apo ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

Megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk e rregullon çështjen e konfliktit të interesit edhe për periudhën paszgjedhore. Duhet parë nëse ka konflikt interesi në financimin e partive jo vetëm para datës së zgjedhjeve, por edhe pas tyre.

Përveç kësaj, duhen parashikuar kufizime edhe për donatorët individualë, në mënyrë që donatorët e partive të mos caktohen pas zgjedhjeve në funksione publike në administratën shtetërore apo në shoqëritë me kapital shtetëror.

Kodi Zgjedhor duhet të specifikojë institucionin që duhet të ushtrojë kontroll mbi këto çështje dhe të parashikojë sanksionet përkatëse në rast të shkeljeve të tyre.

Për këtë qëllim, neni 89 i Kodit Zgjedhor duhet ndryshuar.

**10.** Ligji "Për partitë politike" nuk bën një rregullim të reklamave politike në media gjatë aktivitetit vjetor të partive politike (fushatave jozgjedhore). Edhe pse ligji nuk garanton për partitë barazi çmimesh për reklamat mediatike, partitë kanë në fakt akses në reklamat mediatike me pagesë. Frekuenca e reklamave është e lartë, sidomos gjatë fushatave zgjedhore apo edhe përpara fillimit zyrtar të fushatave. Po të krahasosh çmimet e zakonshme të kompanive mediatike, kostoja e kohës televizive dhe reklamave duket e lartë; partitë duhet t'i bëjnë publike detajet e këtyre kostove në raportimet e tyre financiare. Vendimmarrësit duhet të shqyrtojnë me kujdes nëse nevojitet që kohëzgjatja e fushatës zgjedhore të zbatohet në mënyrë më efektive (apo të ndalohen reklamat jashtë fushatës zgjedhore), apo nëse duhet të kufizohen reklamat (për shembull të ndalohen në televizionet private apo të kufizohet ndjeshëm sasia në mënyrë që



të zvogëlohen shpenzimet).

Prandaj, nevojitet që ligji "Për partitë politike" të përmbajë disa nene që garantojnë stimuj financiarë për kompanitë mediatike që ato të bëjnë publike informacionet mbi kohën televizive dhe kostot e reklamave të paguara nga partitë politike.

**11.** Kodi Zgjedhor dhe ligji "Për partitë politike" duhet të parashikojnë qartësisht kompetencën e KQZ-së për t'i paraqitur konstatimet e saj për shqyrtim pranë prokurorisë apo zyrës së administratës tatimore.

**12.** Kodi Zgjedhor dhe ligji "Për partitë politike" duhet t'u ofrojnë një lloj garancie apo mbrojtjeje ekspertëve kontabël që ata ta kryejnë punën e tyre në mënyrë të paanshme, të ndershme dhe profesionale, pa ndikime apo intimidim të jashtëm politik, sidomos kur auditojnë financimin e partive kryesore në pushtet apo partive që fitojnë zgjedhjet.

**13.** Neni 84, paragrafi 6 i Kodit Zgjedhor krijon një burim financiar shtesë për partitë e rëndësishme politike. Mënyra se si ai zbatohet implikon në transaksione financiare dhe aktivitete fiskale edhe institucionet mediatike, duke krijuar situata ekonomike konfidenciale mes partive dhe radio/televizioneve. Ky është një nen shumë i vështirë për t'u monitoruar dhe përfshin disa struktura monitorimi (bordin e medias, zyrën e tatimeve, etj.).

Ky nen është zbatuar në mënyrë arbitrare në zgjedhjet e vitit 2011 nga të paktën një parti dhe dy kompani mediatike, edhe pse ai duhet të zbatohet vetëm për zgjedhjet parlamentare.

Neni 84 paragrafi 6 i Kodit Zgjedhor parashikon se "Për zgjedhjet në Kuvend radiot dhe televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, sipas këtij neni, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës së parashikuar në pikën 5 të këtij neni t'ua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore. Kostoja për vënien e kohës në dispozicion falas subjekteve zgjedhore nga ana e radiove dhe televizioneve private llogaritet si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore. Ngarkohen KQZ-ja, KKRT-ja dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse." Këtu kemi dy çështje: i) financimi i 50% të kohës nga shteti është financim shtesë i fshehur, dhe për më tepër sasia e këtij financimi nuk është e qartë, sepse dispozita shprehet gjysma e kohës, jo gjysma e kostos; dhe ii) në praktikë, Open Data Albania ka vëzhguar që një parti politike ka raportuar që për zgjedhjet lokale të vitit 2011 kishte përfituar, në bazë të nenit 84, paragrafi 6 të Kodit Zgjedhor, kohë falas për reklamë politike të vënë në dispozicion nga radio/televizionet private, që u llogarit si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore. Ky element i veçantë i bilancit u regjistrua si zë më vete nga eksperti kontabël.

**14.** Neni 90, paragrafi 2 i Kodit Zgjedhor i lejon publikut të ketë akses në informacionet rreth donacioneve me vlerë më të lartë se 100 000 lekë. Ligji parashikon që këto të dhëna duhet të bëhen "gjithmonë publike", që do të thotë se e drejta e informimit fillon në momentin që donacioni regjistrohet në llogarinë bankare përkatëse.

Gjatë Fushatës Zgjedhore të vitit 2013, ekipi që punoi për Open Data Albania u kërkoi me shkrim tetë partive kryesore që të bënin publik donatorët e tyre që nga fillimi i fushatës. Megjithatë kërkesa u bë në formë zyrtare, ky informacion nuk u vu ndonjëherë në dispozicion



qoftë gjatë apo pas fushatës. Partitë politike u përpoqën të argumentonin se ato nuk janë objekt i kësaj dispozite ligjore, dhe disa prej tyre u përgjigjën edhe se ato nuk janë objekt i të drejtës për informim, d.m.th. nuk janë të detyruara nga ligji shqiptar për të drejtën e informimit që ta japin këtë informacion.

Ndaj, Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar në mënyrë të tillë që të garantojë transparencën dhe të drejtën e informimit mbi financimin e partive politike. Ligji duhet jo vetëm të parashikojë dhënien e informacioneve të një natyre të përgjithshme, por edhe të japë zgjidhje efektive dhe të përcaktojë sanksione në raste shkeljesh.

**15.** Duhet të fuqizohet roli i KQZ-së duke i siguruar asaj buxhet dhe burime njerëzore të mjaftueshme për të ushtruar në kohë dhe me efikasitet kompetencat që i jep ligji. Kjo mund të realizohet në bazë të një vlerësimi të detajuar të ndikimit rregullator.

**16.** Ligji duhet të ofrojë mekanizma për ta bërë pjesëmarrjen në auditimin e financimit të partive politike më tërheqëse për ekspertët e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë. Detyra e ekspertëve kontabël është shumë delikate dhe ligji i detyron ata që të konstatojnë dhe të firmosin raporte mbi rregullsitë apo parregullsitë financiare të subjekteve shumë të fuqishme (ekzekutive dhe legjislative).

Çështja e pagave të papaguara duhet të zgjidhet përmes buxhetit të KQZ-së. KQZ-ja, si organi administrativ që u ngarkon detyra ekspertëve kontabël përmes shortit, është e detyruar të garantojë që ata do të paguhen për punën që vetë KQZ-ja u ngarkon. Në rastet kur partitë politike nuk e përmbushin këtë detyrim për të bërë pagesat, atëherë KQZ-ja duhet të paguajë për shërbimet e ekspertëve kontabël dhe ta llogarisë shumën si një detyrim që partitë ia kanë asaj.

**17.** Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar në mënyrë që të parashikojë një zvogëlim proporcional të financimit të partive politike nga fondet publike gjatë fushatave zgjedhore, nëse ato nuk respektojnë kuotën gjinore të parashikuar në Kodin Zgjedhor.

## **B.6. Organizimi dhe zhvillimi i Konferencës: "Kodi Zgjedhor mundësi për përmirësime".**

### **KQZ i përcjell Kuvendit të Shqipërisë gjetjet dhe rekomandimet e tryezave teknike të zhvilluara.**

Gjetjet dhe rekomandimet për mundësinë e përmirësimeve ligjore, me qasje aspekte nga më të rëndësishmet të procesit zgjedhor, produkt i 5 Tryezave Teknike, u prezantuan për përfaqësuesit e partive politike shqiptare, përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, drejtuesit e trupave zgjedhore të rajonit, përfaqësuesit e mediave, përfaqësuesit e shoqërisë civile, të Policisë së Shtetit, ekspertë zgjedhore etj, në Konferencën "Kodi Zgjedhor: Mundësi për Përmirësim", e cila u mbajt në Tiranë më datë 30 qershor 2014.

Konferenca u organizua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve së bashku me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, Këshillin e Europës, dhe UN Women.

Kryetari i Prezencës së OSBE-së, Ambasadori Florian Raunig, që hapi punimet e konferencës dha



mesazhin e rëndësishëm për të gjithë autoritetet shqiptare, dhe me vlerë të veçantë për KQZ-në si institucioni shtetëror që organizon dhe menaxhon procesin zgjedhor: me afrimin e zgjedhjeve vendore është koha për autoritetet shqiptare të zhvillojnë një plan për zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it.

KQZ, me organizmin e pesë tryezave teknike, diskutimet gjithpërfshirëse të shumë aktorëve, faktorëve dhe grupeve të interesit, synoi dhe realizoi dhënien e kontributeve të drejtpërdrejta me qasje rekomandime për përmirësime të mundshme të Kodit Zgjedhor në aspekte, të cilat shenjojnë standardet e procesit zgjedhor, por njëherazi synoi forcimin e rolit institucional të KQZ-së, nëpërmjet krijimit të një marëdhënie më bashkëpunuese me të gjithë aktorët me rol të drejtpërdrejtë ose indirekt në procesin zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes kësaj Konference ja përcolli Kuvendit të Shqipërisë këtë paketë të gjërë rekomandimesh, me besimin se paketa e rekomandimeve që bën bashkë mendimin e aktorëve zgjedhorë; atyre teknikë, të partive politike, shoqërisë civile, medias dhe grupeve të interesit, do të ketë vëmendjen dhe vlerësimin e ligjvënësve për përmirësim të ligjit zgjedhor në një reformë të mundshme zgjedhore.

### **B.7. KQZ- për përmirësime të Kodit Zgjedhor në funksion të anës organizative dhe administrimit të procesit**

Pjesë e paketës propozuese me rekomandime për përmirësime të Kodit Zgjedhor, krahas gjetjeve të tryezave konsultative teknike të organizuara me pjesëmarrjen e aktorëve dhe faktorëve të interesit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bëri edhe propozimet e vetë institucionit për ndryshime/plotësime të dispozitave të caktuara të Kodit Zgjedhor, në funksion të përmirësimit të anës organizative dhe administrimit të procesit. Konkretisht:

- Raporti i OSBE-ODIHR-it në rekomandimet e para prioritare, ka përcaktuar se duhet të rishikohet Kodi Zgjedhor për sa i përket përkufizimit të aktit normativ të KQZ-së, dhe akteve të tjera të cilat duhet të miratohen me shumicë të cilësuar. Sipas Rekomandimit të Raportit duhet të unifikohet përkufizimi në Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Gjykatat Administrative për aktin normativ të KQZ-së.
- Përveç kësaj, në zgjedhjet e fundit të zhvilluara për Kuvendin dhe për Organet e Qeverisjes Vendore, ka qenë mosmarrveshje e vazhdueshme në lidhje me llojin e aktit të KQZ-së. Mosmarrveshje të cilat dhe Kolegji Zgjedhor i ka zgjidhur në mënyra të ndryshme duke mos arritur në unifikimin e praktikës gjyqësore.
- Në analizë të sa më sipër përkufizimi për Aktet nënligjore normative të KQZ-së në Kodin Zgjedhor duhet të referojnë tek dispozita konkrete për përcaktimet e aktit normative në Ligjin nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".
- Në funksion të rritjes së efikasitetit të punës së komisioneve të nivelit të dytë, të cilat angazhohen në detyrë për një periudhë disa mujore, si dhe në vlerësim të detyrave dhe përgjegjësisive të rëndësishme të tyre për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në zonën e



administrimit zgjedhor, është propozuar që gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës, anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, të pezullohen nga detyra kur ata janë nëpunës të administratës publike, dhe për gjatë kësaj kohe t'i ruhet vendi i punës.

- Përcaktimi si detyrim ligjor për strukturat përkatëse të komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë i dërgimit të menjëhershëm në KQZ të vendimeve për emërimin/lirimin, apo shkarkimin e anëtarëve të komisioneve të nivelit më të ulët. Disponimi nga ana e KQZ-së, menjëherë pas miratimit, të akteve për emërimin/lirimin, apo shkarkimin e komisionerëve të nivelit të tretë, i shërben kontrollit, administrimit dhe menaxhimit më të mirë të procesit nga KQZ, kjo sa i përket kontrollit të respektimit të ligjit nga komisionet e nivelit të dytë (emërimeve në afat dhe në përputhje me kriteret ligjore), si dhe përmbushjes së detyrimit ligjor nga ana e KQZ-së për krijimin e bazës së të dhënave për komisionerët zgjedhorë, po ashtu dhe monitorimit të trajnimit të tyre.
- Përcaktimi si detyrim ligjor për partitë kryesore të shumicës dhe opozitës parlamentare, që propozimet për zëvendësim të anëtarëve apo sekretarëve të KZAZ, në çdo rast duhet t'i përkasin gjinisë të anëtarit/sekretarit që do të zëvendësohet. Kjo i shërben ruajtjes së kuotës gjinore, detyrim i përcaktuar për këto parti, jo vetëm në propozimet fillestare, por përgjatë gjithë procesit. Eksperiencat kanë dëshmuar se partitë politike e ushtrojnë të drejtën ligjore për lirim-emërim të anëtarëve të KZAZ-së gjatë gjithë procesit, edhe ditën e zgjedhjeve.

### **C. TRAJNIME TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR ADMINISTRIMIN ZGJEDHOR JASHTË PERIUDHËS ZGJEDHORE PËR PERSONA TË INTERESUAR**

Kodi Zgjedhor, në nenin 21, pika 10, përcakton si kompetencë të KQZ kryerjen e trajnimeve për administrim zgjedhor jashtë periudhës zgjedhore dhe në mënyrë periodike për të gjithë të interesuarit, duke përcaktuar se këto trajnime mund të jenë të përgjithshme dhe të specializuara për funksione të veçanta të administrimit të zgjedhjeve.

Për përmbushjen e kësaj kompetence, që në thelb është marrja e përgjegjësive ligjore për kryerjen e trajnimeve të vazhduara në funksion të rritjes së cilësisë së njohjes së ligjit zgjedhor dhe procedurave ligjore nga persona të përfshirë direkt/indirekt në proceset zgjedhore, KQZ synoi realizimin e një procesi efektiv gjithëpërfshirës, si nëpërmjet tematikave të trajnimit, ashtu dhe shtrirjes gjeografike.

Raporte të vëzhguesve ndërkombëtarë, të organizatave vendase, apo problematika të raportuara nga media, gjatë apo në përfundim të proceseve zgjedhore, kanë evidentuar probleme të cilësisë së njohjes së ligjit zgjedhor dhe procedurave, jo vetëm nga persona të përfshirë direkt në proceset zgjedhore (komisionerë, votues), por edhe ata të përfshirë indirekt (media, vëzhgues). Problemet, pavarësisht natyrës së tyre, pavarësisht faktit se shfaqen tek personat me rol të drejtpërdrejtë apo indirekt në procesin zgjedhor, kanë një emërues të përbashkët: cenimin e standarteve të procesit zgjedhor.

Këto fakte diktuan për KQZ-në nevojën që trajnimet jashtë zgjedhore t'i strukturojë dhe



zhvillojë, jo duke i parë thjesht si përmbushje e detyrimit ligjor, por nëpërmjet tyre të synonte ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin me qëllim minimizimin apo eliminimin e problemeve apo "defekteve" të evidentuara përgjatë proceseve zgjedhore.

Nisur nga ky qëllim, KQZ trajtoi tema gjithpërfshirëse, si dhe synoi përfshirjen dhe trajnimin e një rrethi sa më të madh aktorësh: votues, burime njerëzore që partitë politike synojnë t'i angazhojnë si komisionerë apo vëzhgues, nëpunës të administratës vendore që angazhohen me përgatitjen e listës së zgjedhësve dhe caktimin e qendrave të votimit, gazetarë që ndjekin dhe raportojnë për procesin zgjedhor.

KQZ, duke e mirë strukturuar këtë veprimtari përgjatë vitit 2014, synoi të jetë më pro-aktive në ushtrimin e rolit, përgjegjësi dhe përmbushjes së kompetencave me qëllim të kuptuarit të mirë të ligjit zgjedhor dhe zhvillimeve të procesit zgjedhor nga një numër sa më i madh shtetasish.

### **Objektivat dhe grupet e synuara:**

- Transmetimi tek një numër sa më i madh të interesuarish i njohurive zgjedhore të përgjithshme për sistemin dhe ciklin zgjedhor, aktorët e përfshirë në çdo etapë të ciklit zgjedhor, roli dhe përgjegjësitë e tyre. Ky objektivi synonte kryesisht votuesit, për t'i ndërgjegjësuar ata për rëndësinë dhe vlerën e votës së tyre për demokracinë, garancitë për ruajtjen e fshehtësisë dhe integritetit të votës; gazetarët, për t'i sensibilizuar për rolin e rëndësishëm të medias gjatë procesit në respekt të mirë informimit publik, për t'i ndërgjegjësuar se kuptimi i mirë i ligjit dhe procedurave zgjedhore, është domosdoshmëri për punën e tyre, etj.
- Transmetimi tek një numër sa më i madh të interesuarish i njohurive zgjedhore, për funksione të veçanta të administrimit zgjedhor: detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, duke synuar të interesuarit që kanë interes për angazhim në administrimin e procesit zgjedhor, si komisionerë zgjedhorë apo vëzhgues;
- Trajnimi i strukturave përkatëse të njësisve të qeverisjes vendore për detyrat dhe përgjegjësitë që i ngarkon ligji zgjedhor; ndërgjegjësimi se përmbushja në kohë dhe korrektësisht e tyre ka rëndësi të madhe për mbarëvajtjen e përgatitjeve për procesin zgjedhor; argumentimi pse vonesat e përmbushjes në kohë të detyrave nga këto struktura pasjellin vonesa kohore të shumë etapave përgatitore të procesit, duke vënë në vështirësi realizimin e procedurave të tjera etj.
- Trajnim i të rinjve, në fokus zgjedhësit që votojnë për herë të parë, për të drejtat dhe detyrat e zgjedhësit në etapa të ndryshme të procesit zgjedhor, qartësimi i procedurave të votimit (spjegim teorik dhe simulim praktik).

### **Kalendari i zhvillimit të trajnimeve jashtë periudhës zgjedhore gjatë vitit 2014 :**

Trajnimet jashtë zgjedhore, sikundër u planifikuan qysh në pikënisje, u realizuan në 10 qytete kryesore (qendër qarku), Lezhë, Fier, Tiranë, Durrës, Kukës, Gjirokastër, Peshkopi, Vlorë, Elbasan, Berat, duke konsideruar fakte si procesin mësimor për shkollat e mesme dhe universitetet, mosplanifikimin gjatë muajve korrik, gusht, shtator për shkak të specifikave (leje



vjetore, pushime, fillimi i vitit shkollor etj).

### **Temat e trajtuara**

Sesionet e trajnimit për funksione të veçanta të administrimit zgjedhor, trajtuan temat:

- "Ngritja/funksionimi/detyrat e Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor (KZAZ)";
- "Ngritja/funksionimi/detyrat e Komisionit të Qendrës së Votimit (KQV)".

Sesionet e trajnimit për njohuri të përgjithshme për administrimin zgjedhor trajtuan temën:

- "Sistemi zgjedhor, administrata zgjedhore, institucionet e ngarkuara me detyra nga Kodi Zgjedhor, cikli zgjedhor, roli i medias".

### **Bashkëpunimi institucional për realizimin e veprimtarisë**

Realizimi i trajnimeve zgjedhore gjatë vitit 2014, diktonte nevojën e bashkëpunimit me qeverisjen vendore, si për anën logjistike (vënia në dispozicion e ambjentëve me kushte optimale) si dhe për sa i përket pjesëmarrjes.

KQZ, falenderon Bashkitë e Lezhës, Fierit, Tiranës, Durrësit, Kukësit, Gjirokastrës, Peshkopisë, Vlorës, Elbasanit dhe Beratit, të cilat mundësuan ambiente optimale për zhvillimin e trajnimeve, si dhe bënë pjesë të këtyre trajnimeve nëpunës të administratave të tyre.

Përgjashtimisht, kërkesës së KQZ-së për bashkëpunim, megjithë ripërsëritjen e saj, nuk i janë përgjigjur Bashkia Korçë dhe Bashkia Shkodër. Për këtë shkak, kalendari i trajnimeve nuk u realizua në këto qytete.

E një rëndësie të veçantë, dhe shumë i suksesshëm ishte bashkëpunimi me Drejtoritë Rajonale Arsimore të qarqeve Lezhë, Fier, Tiranë, Gjirokastrë, Peshkopi, Vlorë, Elbasan dhe Berat, të cilat mundësuan pjesëmarrjen në sesionet e trajnimeve të maturantëve të shkollave të mesme, si dhe Drejtoritë e Shkollave të Mesme, të cilat kontribuan në realizimin e veprimtarisë nëpërmjet organizimit të maturantët në grupe, si dhe vunë në dispozicion të KQZ-së ambientet e shkollave. Gjithashtu, i frytshëm ishte bashkëpunimi me Rektoratet e Universiteteve të Elbasanit, Gjirokastrës dhe Tiranës, të cilët, në vlerësim të rëndësisë së veprimtarisë vunë në dispozicion të KQZ salla leksionesh me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, si dhe mundësuan pjesëmarrjen në trajnime të një numri të madh studentësh, disa prej të cilëve kishin eksperiencë si komisionerë zgjedhorë.

### **Partitë politike, vullnet i munguar për bashkëpunim**

KQZ, vazhdimisht ka sjellë në vëmendje të opinionit publik, partive politike në veçanti, nevojën që e gjithë trupa e administrimit zgjedhor, duhet të dëshmojë më shumë profesionalizëm, në funksion të mirëadministrimit të procesit, si dhe të rritjes së besueshmërisë publike në administrimin e procesit zgjedhor.

KQZ, duke e vlerësuar zhvillimin e këtyre veprimtarive si një mundësi të shtuar për burimet njerëzore të partive politike, për të cilat ka interes për të rritur profesionalizmin për çështje zgjedhore, ju drejtua në vijimësi partive politike parlamentare duke kërkuar bashkëpunimin e



tyre sa i përket pjesëmarrjes, me synimin nga këto sesione trajnimi të përfitonin edhe target-grupet të cilat partitë politike synojnë t'i angazhojnë si komisionerë apo vëzhgues në zgjedhjet e ardhshme.

Pavarësisht njoftimeve në vijimësi të KQZ-së për kohën dhe vendin e zhvillimit të sesioneve të trajnimit, dhe kërkesës për përfshirjen në këtë veprimtari të një numri sa më të madh nga burimet njerëzore të partive politike, duke çmuar se kjo do t'i shërbente qëllimit të përbashkët për rritjen e standarteve të zgjedhjeve të ardhshme, partitë politike nuk dëshmuuan vullnet politik për të mbështetur veprimtarinë.

### **Transparenca e veprimtarisë, përpjekjet për të rritur pjesëmarrjen**

Të interesuarit janë njoftuar/ ftuar në sesionet të trajnimeve jashtë zgjedhore në çdo qytet, nëpërmjet TV kombëtar, mediave lokale, faqes zyrtare të KQZ-së. Njoftimet në çdo rast përmbanin vendin e zhvillimit të trajnimeve, orarin e sesioneve dhe tematikën e çdo sesioni.

### **Infrastruktura dhe logjistika:**

Trajnimet janë realizuar në sallat e leksioneve të Universiteteve, sallat e mbledhjeve të këshillave të Bashkive, qendra kulturore dhe edukuese, si dhe në ambjentet e shkollave të mesme.

Prezantimi i temave, është shoqëruar me prezantime në poërpoin, si dhe me demonstrimin praktik të mënyrës së kryerjes së procedurave të ndryshme nga administratorët zgjedhorë, po ashtu në çdo rast me të rinjtë janë simuluar kryerja e procedurave të votimit në qendrën e votimit (të rinjtë aktivizoheshin si komisionerë/vëzhgues/votues).

### **Vlerësimi i pjesëmarrësve për sesionet e trajnimit të realizuara në periudhë jashtë zgjedhore**

Pjesëmarrësit në këto trajnime (600 numri i tyre), në pyetësorët e plotësuar në fund të veprimtarive, kanë shprehur vlerësime dhe interes për të marrë njohuri zgjedhore dhe më tej, si dhe kanë evidentuar nëpërmjet plotësimit të rubrikave të veçanta, çështje për të cilat kërkojnë qartësim më të detajuar/njohuri më të hollësishme.

Gjithashtu, pjesëmarrësit të cilët kishin eksperiencë si komisionerë zgjedhorë, vlerësuan si tejet pozitive trajtimin e njohurive dhe procedurave ligjore zgjedhore në mënyrë të vazhduar, si mënyra me efikasë për përfitim të tyre nga të gjithë, veçanërisht nga ata që kryejnë administrim zgjedhor në procesin zgjedhor. Ata theksuan se, trajnimi për administrim zgjedhor, i kryer vetëm në prag të procesit zgjedhor, në presion të kohës dhe për një sërë shkaqesh, dëshmon reduktim të efektivitetit të tij.





## **D. ORGANIZIMI I PROGRAMEVE PËR EDUKIMIN ZGJEDHOR TË SHTETASVE JASHTË PERIUDHËS ZGJEDHORE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të kompetencës së tij, përcaktuar në nenin 21, pika 9, të Kodit Zgjedhor, merr masa dhe organizon programe për edukimin zgjedhor të shtetasve. Programet për edukimin zgjedhor të shtetasve, të zhvilluara nga KQZ në vijimësi gjatë vitit 2014, në takime të drejtpërdrejta me zgjedhësit, në 9 qarqe të vendit: Tiranë, Lezhë, Fier, Durrës, Gjirokastër, Kukës, Dibër, Vlorë, Berat, jo vetëm i kanë shërbyer përmbushjes së detyrimit ligjor, por kanë krijuar mundësitë për të evidentuar drejtpërsëdrejti nevojat e zgjedhësve për informacion lidhur me procesin zgjedhor në tërësi si dhe aspekte të veçanta të tij, mënyrat dhe mjetet më efikase për të shpërndarë informacionin, si në drejtim të edukimit, sensibilizimit apo informimit.

KQZ, duke e mirë strukturuar këtë veprimtari përgjatë vitit 2014, synoi të jetë më pro-aktive me votuesit e rinj, duke synuar të rrënjosë tek ta kulturën zgjedhore të pjesëmarrjes në votime, t'i ndërgjegjësojë ata për rëndësinë dhe vlerën e votës, si gur i themeli i demokracisë.

Në 26 sesionet e edukimit të zhvilluara gjatë vitit 2014, kanë marrë pjesë në total rreth 1000 votues, kryesisht të rinj dhe votues për herë të parë, të cilët ishin dhe target-grupi i synuar i programeve edukuese është trajtuar tema "Të votosh vlerë e demokracisë - e drejtë dhe detyrë qytetare", e shoqëruar me simulim praktik të procedurave të votimit në qendrën e votimit.

Prezantimi i temës, është shoqëruar me prezantime në poëerpoint, si dhe me demonstrimin praktik të mënyrës së kryerjes së procedurave të ndryshme nga administratorët zgjedhorë, po ashtu në çdo rast me të rinjtë janë simuluar kryerja e procedurave të votimit në qendrën e votimit (të rinjtë aktivizoheshin si komisionerë/vëzhgues/votues).

Zhvillimi i këtyre veprimtarive edukuese u pritën me mjaft interes në të gjithë qytetet nga të rinjtë pjesëmarrës, për shumë prej të cilëve votimi në zgjedhjet e 21 qershorit 2015, do të jetë një eksperiencë e re. Këto sesione edukimi, të zhvilluara në formën e bashkëbisedimeve me të rinjtë, synonin të qartësonin sa më shumë të rinjtë për çdo aspekt të procesit zgjedhor, veçanërisht për dokumentat e vlefshme për votim, procedurat e votimit, mënyra dhe procedurat për të asistuar personat që nuk mund të votojnë vetë, si dhe të ndërgjegjësonin ata për fenomene negative si votimi familjar, ndikimi i vullnetit me forma të ndryshme etj.

Nëpërmjet pyetsorëve të plotësuar në fund të çdo programi edukues nga të rinjtë, janë evidentuar aspektet e procesit zgjedhor për të cilat ky target grup ka më tepër interes për informacion:

- si veprohet kur nuk gjendet emri në listën e zgjedhësve apo kur ai përmban pasaktësi;
- procedurat e votimit në qendrën e votimit dhe gjatë kryerjes së aktit të votimit, të drejtat dhe detyrimet e zgjedhësit.
- si dhe mënyrat/format e preferuara nga të rinjtë për informimin për procesin zgjedhor: nëpërmjet rrjeteve sociale si facebook dhe twitter.

Veprimtaria edukuese, strukturohej nga sesioni në session, për të qenë më përgjigjëse ndaj



paqartësive dhe nevojave të të rinjve.

Gjithashtu, gjatë vitit 2014 janë zhvilluar takime me qëllim edukimin zgjedhor dhe anketime me zgjedhës të target grupeve specifike si të moshuar, gra, dhe studentë me qëllim evidentimin e paqartësive, problematikave, apo vështirësive që ata hasin gjatë procesit, si dhe për përthitjen e mendimeve për mënyrat më efikase të shpërndarjes së informacionit zgjedhor për ta. Të dhënat e siguruar nga këto anketime, do të jenë baza mbi të cilën KQZ do të ndërtojë projekte të përgjithshme dhe specifike për të dërguar mesazhe edukuese, sensibilizuese dhe informuese për zgjedhësit për zgjedhjet vendore 2015. Në këtë kontekst, KQZ ka ndërtuar dhe miratuar strategjinë për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet e datës 21.06.2015, me tipar kryesor të metodologjisë së saj, kontaktin e drejtpërdrejtë me zgjedhësin, si forma më ecentrike për informim, vlerësuar prej tyre.

**Sigurimi i ambienteve për zhvillimin e programeve edukuese:**

Për sigurimin e ambienteve për zhvillimin e programeve edukuese është bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale Arsimore në qarqe, Drejtoritë e Shkollave të Mesme, Rektoratet e Universiteteve Elbasan, Gjirokastër, Tiranë, Berat, të cilat janë treguar të gatshme, madje duke ofruar edhe më shumë se një ambient për ta vënë në dispozicion të KQZ-së për të mundësuar zhvillimin e programit me disa grupe njëherësh.

**Burimet Njerëzore për realizimin e programeve për edukimin zgjedhor:**

Programet edukuese janë zhvilluar nga nëpunësit e drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, dhe në disa prej tyre me të rinjtë ka bashkëbiseduar Kryetarja e KQZ-së dhe anëtarët e KQZ-së.

### **Infrastruktura dhe logjistika:**

Programet e edukimit janë realizuar në sallat e leksioneve të Universiteteve, sallat e mbledhjeve të këshillave të Bashkive, zyrat e DAR, Qendrave kulturore dhe edukuese dhe në ambientet e shkollave të mesme.

### **Vlerësimi i programeve edukuese nga të rinjtë**

Të rinjtë, i vlerësuan si mjaft të rëndësishme këto programe edukuese, të cilët harmonizonin aspektin teorik të të drejtave dhe detyrave të shtetasve, për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur, me aspektin praktik. Maturantët u shprehën se njohuritë për procesin zgjedhor, të dhëna gjatë procesit mësimor vetëm në një temë, në lëndën e qytetarisë, janë krejtësisht të pamjaftueshme. Për më tepër, që kjo temë trajtohet në vitin e parë të shkollës së mesme, kur ata nuk janë në moshën 18 vjeçare, pra jo në kohën e duhur kur ata kanë interes të shtuar për të, kur mbushin moshën për të qenë zgjedhës.

Kjo eksperiencë e administruar do të shërbejë si bazë për të ndërtuar programe edukimi gjatë vitit 2015, ku do të ketë intensifikim në gjysmën e parë të vitit e cila korrespondon me zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, për t'u vijuar më tej edhe në gjysmën e dytë të vitit 2015, në përputhje me vizionin e institucionit: edukimi është çelësi i suksesit për standardet e proceseve të ardhshme zgjedhore.



## **E. KËRKESA PËR REFERENDUM VENDOR NGA GRUPE NISMËTARE**

### **E.1. Paraqitja dhe verifikimi i kërkesave nga grupet nismëtare, për fillimin e procedurave përkatëse, për zhvillimin e referendumeve vendore në disa njësi të organeve të qeverisjes vendore.**

Në datat 30, 31.10.2014, dhe 1, 2, 3, 4, 5. 11.2014, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u paraqitën 136 kërkesa për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumeve vendore në nivel të njësisë bazë të qeverisjes vendore vendore për 136 bashki dhe komuna. Kërkesat u depozituan nga 136 Grupe Nismëtare.

KQZ, në mbështetje të nenit 132, pika 4, nenit 126, pika 2 dhe nenit 127, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003, i ndryshuar, nëpërmjet strukturave të saj organizoi punën për verifikimet nëse nismëtarët e depozitimit të kërkesës, janë zgjedhës të Komunës përkatëse, në të cilën kërkohej të zhvillohej referendumi. Verifikimi i kërkesës u bë duke e bazuar vetëm mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur duke patur objekt verifikimi:

- Nëse nismëtarët janë shtetas shqiptar që kanë mbushur moshën 18 vjeç në ditën e depozitimit të kërkesës.

- Nëse nismëtarët kanë vendbanimin në Njësinë vendore përkatëse.

Administrata e KQZ, brenda afateve ligjore verifikoi dokumentacionin për 2168 kërkesit dhe rezultoi se kërkesit Grupet Nismëtare për 130 kërkesa plotësonin kriteret ligjore, pasi plotësonin numrin e kërkuar dhe ishin zgjedhës të njësisë vendore përkatëse në kohën e depozitimit të kërkesës.

Në mbështetje të nenit 127 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, i ndryshuar, KQZ pasi verifikoi dokumentacionin e depozituar dhe konstatoi se Grupet Nismëtare legjitimoheshin si të tillë, miratoi Fletën-Tip, përcaktoi koston për fletës tip për çdo Grup Nismëtar dhe pajisi kundrejt pagesës grupet nismëtar me fletën tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme, të cilat duhet të depozitohen nga zgjedhës në kohën e paraqitjes së kërkesës në KQZ-së.

Partia Socialiste, ushtroi të drejtën e ankimit kundër vendimeve përkatëse të KQZ-së të mara më datë 14.11.2014, "Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi nismëtarësh për fillimin e procedurave, për zhvillimin e një referendumi në Komunën/Bashkinë përkatëse", duke i kërkuar Kolegjit Zgjedhor, gjykimin e çështjes në themel, pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimit të KQZ-së.

Kolegji zgjedhor me vendimin nr. 1, datë 14.01.2015 vendosi:

- Pranimin e padisë.

- Shfuqizimin e vendimeve përkatëse të mara më datë 14 Nëntor 2014 (nga numri 24-160) të KQZ-së dhe rrëzimin e kërkesës së grupit nismëtar për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor në disa njësi të organeve të qeverisjes vendore.



## **F. VEPRIMTARIA E KQZ-SË PËR PËRGATITJEN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE 2015**

### **F.1. Përditësimi i moduleve/programeve kompjuterike të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë 2013, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015.**

Sic jeni në dijeni për Zgjedhjet për Kuvendin 2013, me mbështetjen financiare të USAID dhe teknike të IFES, filloi puna për ndërtimin e një paketë të plotë programesh kompjuterike për administrimin e integruar të informacionit zgjedhor (Sistemi i Integruar i Manaxhimit të Informacionit Zgjedhor - Integrated Elections Management Information System-IEMIS). Me projektin e realizuar në bashkëpunim me IFES për Zgjedhjet e Kuvendit 2013 u realizuan këto module:

- Moduli 1: Ndjekja e shpërndarjes së materialeve zgjedhore.
- Moduli 2: Menaxhimi i funksioneve në ditën e zgjedhjeve (hapja e votimit, pjesëmarrja në ore të caktuara, bllokimi eventual i votimit, mbyllja e votimit).
- Moduli 3: Konsolidimi i rezultateve (hedhja, kontrolli dhe transmetimi i rezultateve nga Vendet e Numërimit të Votave (VNV) në KQZ).
- Moduli 4 : Raportimi në natën e zgjedhjeve – ENR/RNZ- Rezultatet Natën e Zgjedhjeve (Faqja zyrtare për rezultatet)
- Moduli 5: Auditimi, investigimi dhe raportet e brendshme dhe pas zgjedhjeve
- Moduli për programet online të trajnimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore.

Menjëherë pas zgjedhjeve për Kuvendin 2013, KQZ filloi punën e koordinimit me donatorë të ndryshëm për të mundur ndërtimin e plotë të IEMS-së. Gjatë vitit 2014 mundëm të sigurojmë financime vetëm për "Përshtatja për zgjedhjet vendore e moduleve të zhvilluara për zgjedhjet parlamentare", të përmendura më sipër. Financimi u dha përsëri nga USAID dhe u asistua nga nënkontraktori Assist Impact.

Në muajin prill u nënshkrua një Memorandum Mirekuptimi ndërmjet Assist Impact/USAID dhe KQZ-së dhe filloi menjëherë puna. Ekspertët e huaj, të kontraktuar nga donatori, në bashkëpunim me specialistët e KQZ-së bënë një analizë të plotë të kërkesave specifike që kanë zgjedhjet vendore për gjithë modulet që do të përditësoheshin, duke e mbështetur këtë analizë me materialet e nevojshme.

Mbi bazën e analizës së bërë u përgatitën specifikimet teknike të softeve, u bë dizajni i sistemit, u zhvilluan modulet përkatëse, u instaluan në serverin e KQZ-dhe në fillim të muajit tetor 2014 pas testimive dhe rregullimeve përkatëse u bë prezantimi në KQZ. Moduleve të përgatitur do të duhet të bëhen disa rregullime në bazë të ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor si pasojë e ligjit për ndarjen administrative territoriale dhe janë gati për t'u përdorur për zgjedhjet vendore 2015.

KQZ është duke marrë masat për trainimin e administratës zgjedhore, veçanërisht sekretarët e



KZAZ-ve dhe operatorëve të hedhjes të të dhënave në VNV, për përdorimin me efektivitet të këtyre moduleve me synim minimizimin e gabimeve në hedhjen, transmetimin dhe publikimin e rezultateve paraprake të zgjedhjeve nga çdo VNV.

Gjithashtu gjatë vitit 2014 KQZ bashkëpunoi me donatorë të ndryshëm për të siguruar financime për ndërtimin e plotë të Sistemit të Integruar të Manaxhimit të Informacionit Zgjedhor. Ende nuk kemi siguruar financim konkret për plotësimin e Sistemit. Kanë ngelur për t'u zhvilluar edhe modulet e mëposhtme:

Moduli për menaxhimin e procesit për regjistrimin e subjekteve zgjedhore, listave shumëme, verifikimi dhe vlefshmëria e të drejtës të kandidatëve për të kandiduar, përfshi dhe kriterin gjinor për listën.

- Moduli për menaxhimin e ndarjeve administrative, zonave zgjedhore, zonave të administrimit zgjedhor, qendrave të votimit dhe vendeve të numërimit të votave.
- Moduli për menaxhimin e fletës së votimit, zgjedhjet rastësore në renditje, dizajni i fletës së votimit dhe përgatitja për t'u printuar.
- Modulet për menaxhimin e të dhënave për qendrat e votimit (numri i zgjedhësve, vendndodhja, ambienti e kushte të tjera).
- Moduli për menaxhimin e të dhënave për administratën zgjedhore (komisioner të niveleve të ndryshme, vëzhgues).
- Moduli për menaxhimin buxhetor/financiar për komisionet e nivelit të dytë.
- Modulet për përgatitjen e raporteve për buletin zgjedhor.
- Modulet për shpërndarjen e mandateve dhe historinë e tyre (zevendësimet kur një mandat ngelet bosh) i domosdoshëm veçanërisht për zgjedhjet vendore.

## **F.2. Plani Orientues i Veprimeve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 21 qershorit 2015.**

Me daljen e Dekretit të Presidentit të Republikës nr.8844, datë 15.12.2014 për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, KQZ gjatë vitit 2014 miratoi disa akte të rëndësishme për këto zgjedhje. Një nga vendimmarrjet e rëndësishme të KQZ-së është dhe miratimi i planit orientues të veprimeve.

Në këtë kuadër, administrata e KQZ-së përgatiti një plan paraprak të punës për vitin 2015, i cili përkon me vit zgjedhor. Ky plan me formatimin e ri të strukturës së KQZ-së, iu paraqit asaj për miratim. KQZ pas një diskutimi dhe debatimi edhe me përfaqësues të partive politike, miratoi me vendimin nr. 161, datë 24.12.2015 "Miratimi i Planit Orientues të Veprimeve të KQZ-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 21 qershorit 2015".

Veprimet që duhet të ndërmerren nga KQZ, burojnë nga dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe janë një aplikim i tyre në praktikë. Miratimi i këtij plani orientues veprimesh përbën një dokument bazë për nisjen e veprimtarisë së KQZ-së, në përputhje me përcaktimet e nenit 21 të Kodit Zgjedhor. Në këtë mënyrë duke ndërtuar një kalendar të veprimeve të veta KQZ, synonte që procesi përgatitor zgjedhor të vendosej në kornizë ligjore në një sistem të organizuar dhe jo rastësor.

Në këtë plan parashikohen në mënyrë të detajuar të gjitha aspektet që lidhen me përgatitjen e



zgjedhjeve për Kuvendin, duke përcaktuar afatet përkatëse për çdo veprimtari të parashikuar. Miratimi i një plani të tillë është një vendimarrje me mjaft vlerë në procesin përgatitor të zgjedhjeve.

## **G. AKTIVITETE TË PËRGJITHSHME ME PARTNERË NDËRKOMBËTARË**

### **G.1. Bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit**

Komunikimi me faktorin ndërkombëtar ka qenë i pandërprerë dhe transparent. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka intensifikuar komunikimet me të gjitha organizmat ndërkombëtare të akredituara në vendin tonë me qëllim identifikimin e fushave të bashkëpunimit në funksion të mirëadministrimit të procesit zgjedhor. Këto organizata kanë ofruar përkrahje, këshilla dhe ndihmë teknike KQZ-së, dhe kjo ndihmë ka vazhduar gjatë tërë vitit.

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm e permanent mes KQZ dhe organizmave ndërkombëtar Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka zhvilluar takime me përfaqësues të lartë të organizatave ndërkombëtare në vendin tonë si; përfaqësues të OSBE, UNDP, të UN Women në Shqipëri, Këshillit të Europës, USAID, etj, lidhur me zhvillimet pas zgjedhore, me prioritetet, problematikat dhe nevojat që ka KQZ për përmirësimin cilësor të standardeve zgjedhore në të ardhmen.

KQZ, në kuadër të transperencës por dhe të vendosjes së një bashkëpunimi permanent me organizmat ndërkombëtarë që operojnë në fushën e zgjedhjeve që prej Nëntorit të vitit 2012 është pjesë e një grupi pune i krijuar me iniciativën e OSBE që materializohet në takimin mujor të punës me Election Working Group (EWG), praktikë pune kjo tashmë e konsoliduar.

Mbledhja rregullisht e **Election Working Group**, i ka shërbyer qëllimit të koordinimit të pjesëmarrësve në identifikimin e nevojave të KQZ-së dhe të shoqërisë civile për dhënien e asistencës në fushat në të cilat ishte më e nevojshme kjo mbështetje për një administrim më të mirë të procesit zgjedhor në të ardhmen.

Titullarja e institucionit Zj.Luzi ka qenë prezente në organizimin e këtyre takimeve ku rregullisht ka informuar të pranishmit lidhur me veprimtarinë e KQZ-së, problematikat dhe sfidat e ndeshura gjatë punës dhe ka kërkuar dhe mbështetjen e tyre në trajtimin e problemeve ndërmjet organizimit të tryezave teknike me pjesëmarrjen e të gjitha grupeve të interesuara.

Ky bashkëpunim i rëndësishëm si një tregues cilësor dhe pozitiv është jo vetëm dëshmi për përkushtimin në vijimësi të organizmave ndërkombëtarë për të mbështetur KQZ-në, i shërben konsolidimit të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit efikas, por njëherazi i shërben përmirësimit të punës sonë si administratorë zgjedhorë.

Duke vlerësuar realitetin e këtyre takimeve në të gjithë komponentet e tij, sugjerimet dhe rekomandimet e paraqitura në të, KQZ shprehë respektin dhe mirenjohjen për asistencën dhe mbështetjen permanente të afuar në vijimësi nga ky grup pune.



## **G.2. Anëtarësimi dhe përfaqësimi i KQZ në aktivitetet e Mekanizmave Ndërkombëtar Zgjedhore.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Shqipërisë, ka përfituar dhe do të përfitojë nga përvoja dhe mbështetja e mekanizmave ndërkombëtar në arritjen e standarteve zgjedhore të tillë si ACEEEO dhe A-WEB.

Shoqata e Zyrtarëve Zgjedhor të Evropës (ACEEEO) është themeluar më 1991 si një organizatë jo-fitimprurëse dhe rajonale, i cila synon në promovimin e institucionalizimit dhe profesionalizmit të procedurave demokratike në rajon.

1 - KQZ është anëtare Institucionale e Shoqatës së Zyrtarëve Zgjedhorë Europeanë (ACEEEO) që prej vitit 2002 duke përfituar nga aktivitetet e zhvilluara prej saj.

Që në fillimet e saj ACEEEO mblidhet gati çdo vit për të adresuar çështjet aktuale teorike dhe praktike në lidhje me zgjedhjet në rajon.

Konferencat vjetore janë të fokusuar në një shumëllojshmëri të gjerë të temave duke përfshirë transparencën e zgjedhjeve, mediat dhe zgjedhjet, teknologjine zgjedhore, reformën e financave të fushatës, pjesëmarrjen e qytetarëve në këtë proces.

Këto takime janë të rëndësishme për profesionistët e zgjedhjeve të cilët ballafaqohen me menaxhimin, administrimin dhe ndërmjetëson ngjarjet zgjedhore në rrethana sfiduese.

Me ftesë të Shoqatës (ACEEEO) dhe me suportin e OSBE-së, KQZ mori pjesë në cilësinë e anëtarit në Konferencën e 23-të Vjetore dhe Takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës së Zyrtarëve Zgjedhore Europeanë, e cila zhvilloi punimet në datat 4-6 Shtator 2014 në Bukuresht të Rumanisë.

Konferenca, trajtoi në aspektin teorik dhe praktik dy nga aspektet më të rëndësishme të punës së organeve të administrimit zgjedhor: "Pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor dhe në jetën publike", si dhe "Planifikimin e zgjedhjeve të përgjithshme".

Titullarja e institucionit Zj. Luzi ishte përzgjedhur nga organizatorët e konferencës jo vetëm si moderatore por edhe për të ndarë përvojën shqiptare të angazhimit në rritje të grave në jetën publike dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset zgjedhore, duke u ndalur në arritjet dhe sfidat që kanë shoqëruar këtë proces.

2 - KQZ Shqipëri është gjithashtu anëtare e Shoqatës Së Trupave Zgjedhorë (A-WEB), në të cilat prezantohen vizionet e organizatave të trupave zgjedhorë të kontinenteve të ndryshme (Europa, Amerika, Lindja e Mesme dhe Afrika), por dhe organizohen trajnime në aspektin teorik dhe praktik të problematikave me të cilat trupat zgjedhore të vendeve të ndryshme sfidohen në punën e tyre. A-WEB u krijua më Tetor të 2003 dhe brenda një viti përfshiu në gjirin e saj 94 vende anëtare nga gjithë bota ku bën pjesë dhe Shqipëria. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Shqipërisë, si anëtar i kësaj organizate, ka përfituar dhe do të përfitojë nga ekspertiza dhe asistencë e këtij mekanizmi ndërkombëtar në arritjen e standarteve zgjedhore.

Një nga aktivitetet e organizuar dhe e mbështetur nga A-WEB (Shoqata Botërore e Trupave Zgjedhore) ku KQZ Shqipëri u ftua të marrë pjesë ishte "Programi për Zhvillimin e Kapaciteteve të Trupave të Manaxhimit të Zgjedhjeve" i cili u mbajt në Nëntor 2014 në Incheon të Koresë së Jugut. Ky program ofroi një mundësi për shkëmbimin e njohurive zgjedhore ndërmjet zyrtarëve të TMZ në



mënyrë që të kuptonin plotësisht jo vetëm sistemet ekzistuese të menaxhimit të zgjedhjeve në secilin vënd por edhe të diskutonin për mënyrat e përmirësimit të tyre në një kontekst më të gjërë, atë ndërkombëtar.

### **G.3. Vëzhgimi i proceseve zgjedhore**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë vitit 2014, me ftesë të institucioneve homologedhe ë disa raste me mbështetjen financiare të tyre, ka marrë pjesë në vëzhgimin e proceseve zgjedhore lokale, parlamentare dhe presidenciale në disa shtete të rajonit dhe të Evropës. Pjesa tjetër e këtyre aktiviteteve kryesisht, janë realizuar me përkrahjen teknike dhe financiare të OSBE-së, PNUD-it si dhe UN Women.

- Pjesëmarrja në vëzhgimin e procesit të votimit dhe numërimit të votave të datës 16 mars 2014, që u zhvilluan për zgjedhjen e deputetëve të Asamblesë Kombëtare të Republikës së Serbisë dhe zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë së Beogradit.
- Pjesëmarrja në vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 27 prill në Maqedoni, raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare.
- Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare në Hungari më datë 6 prill 2014.
- Pjesëmarrja në vëzhgimin e zgjedhjeve të përgjithshme lokale në Korenë e Jugut, të zhvilluara në datën 04 qershor 2014 .
- Pjesëmarrja në vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të datës 8 qershor në Republikën e Kosovës,
- Pjesëmarrja në vëzhgimin e zgjedhjeve lokale të Gjeorgjisë më datë 15 qershor 2014.

Në kuadër të këtij bashkpunimi, KQZ në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore që do të zhvillohen më datë 21 qershor 2013, do të ftojë homologët e trupave zgjedhore, anëtarë të ACEOO dhe A-WEB-it, për të vëzhguar nga afër procesin zgjedhor dhe për të ndarë dhe shkëmbyer eksperiencat dhe praktikat më të mira zgjedhore, për organizimin dhe zhvelimin e zgjedhjeve sipas standarteve të kërkuara.

### **G.4. Vizita studimore**

Më poshtë, janë prezantuar veprimtaritë kryesore të KQZ-së të realizuara brenda dhe jashtë vendit që, lidhen me shkëmbimin e përvojave dhe bashkëpunimin me organizatat e ndryshme ndërkombëtare. Në mënyrë të përmbledhur, po i paraqesim aktivitetet, si në vijim:

- Një delegacion i KQZ-së i kryesuar nga Kryetarja, në përbërje të së cilit ishin dhe përfaqësues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, zhvilluan në datat 8-10 Shtator 2014 një vizitë studimore në Qendrën e Trajnimit të Vazhduar për Çështjet Zgjedhore të Moldavisë (CICDE). Rritja e efikasitetit të procesit të trajnimit për çdo etapë të procesit zgjedhor, jo vetëm për komisionerët zgjedhorë, por edhe për të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në proces, është një nga drejtimet kryesore të punës në vijimësi të KQZ. Në vlerësim të eksperiencës së administruar, komplekse dhe plot sfida në këtë drejtim, KQZ po synon





përmirësimin e platformës së trajnimit zgjedhor, duke përfituar nga eksperiencat e sukseshme të vendeve me karakteristika të përafërta.

- Në kuadër të bashkëpunimit të KQZ Shqipëri dhe Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Maqedonisë u zhvillua një vizitë zyrtare e cila pati për qëllim shkëmbimin e eksperiencave zgjedhore midis dy institucioneve homologe. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Maqedonisë ishte në prag të përgatitjeve për zgjedhjet presidenciale në muajin prill prandaj dhe interesi i Komisionerëve të Maqedonisë u fokusua në materialin dhe teknikën e përdorimit të gjurmëve të votuesve të përdorura nga KQZ Shqipëri për shkak të përdorimit për herë të parë të bojës timbruese të dukshme me sy të lirë. KQZ në mënyrë të detajuar i përcolli Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të Maqedonisë gjithë informacionin e duhur teknik lidhur me përdorimin e bojës timbruese gjatë procesit të votimit në 23 qershor.
- Me ftesë të UNDP-së, Kryetarja e KQZ-së mori pjesë si moderatore në seminarin e zhvilluar në Prill 2014, Jordani, me temë "Forcimi i besueshmërisë dhe pranimiti i proceseve zgjedhore; Roli i aktorëve zgjedhorë dhe administrata zgjedhore".  
Në këtë aktivitet u arrit që nëpërmjet krahasimit të përvojave në përmbushjen e përgjegjësisë dhe realizimin e transparencës në proceset zgjedhore, të shpërndahej një informacion për praktikat më të suksesshme zgjedhore.  
Duke ju referuar dhe kërkesës së ACEEEO-s (The Association of European Election Officials), Zj. Luzi prezantoi projektet në kuadër të strategjive të reja të kësaj organizate të cilat do të sjellin një vlerë të shtuar në punën e trupave të menaxhimit të zgjedhjeve në rajon, përfshi edhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë.
- Me ftesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë, në datat 14-18 Prill 2014, mbërriti në Tiranë për një vizitë studimore një delegacion i Komisionit Qendror Zgjedhor të Moldavisë lidhur me eksperiencën pozitive të Shqipërisë në përgatitjen dhe shpërndarjen e listës së votuesve.  
Gjatë qëndrimit në Tiranë, ekspertët e KQZ Moldavi u takuan me përfaqësues të organizmave ndërkombëtar si dhe institucione të përfshira në përgatitjen dhe shpërndarjen e listës së votimit si dhe marrjen në konsideratë të mbrojtjes së të dhënave.
- Një delegacion i KQZ-së vizitoi Qendrën e Zhvillimeve të Sistemeve Elektorale, Reformave dhe Trajnimeve, Gjeorgji. Delegacioni u njoh nga afër me platformën e suksesshme të trajnimit të komisionerëve zgjedhorë në Gjeorgji, për të cilën kjo qendër është nderuar me çmimin "International Election Award 2013", organizuar nga Qendra për Studime Parlamentare (ICSP).
- Me ftesë të Këshillit të Lartë Zgjedhor të Turqisë, një delegacion i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mori pjesë në konferencën me temë "Menaxhimi dhe Mbikëqyrja e Zgjedhjeve".



Zyrtarë zgjedhor nga Trupat e menaxhimit të zgjedhjeve të vendeve si, Azerbajxhani, Sudani, Bosnjë-Hercegovina, Gjeorgjia, Kosova dhe Maqedonia shkëmbyen eksperiencat e tyre lidhur me legjislacionin zgjedhor të vendeve pjesëmarrëse si dhe zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare.

Kryetarja e KQZ-së, trajtoi në prezantimet e saj përvojën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë, mbi administrimin e zgjedhjeve dhe zgjidhjet e mosmarrëveshjeve zgjedhore (ankimimet zgjedhore) si dhe mbikqyrjen dhe kontrollin e financimit të shpenzimeve të partive politike në fushatat zgjedhore.

- Në kuadër të bashkëpunimit të mëparshëm me ftesë të KQZ Slloveni, pjesë e administratës së KQZ Shqipëri vizituan këtë institucion me qëllim njohjen nga afër dhe marrjen e eksperiencës lidhur me punën përgatitore që bën ky komision për prodhimin e fletëve të votimit për votuesit e verbër.
- Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me ftesë të Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), mori pjesë në Programin Zgjedhor SH.B.A. 2014, që u zhvillua në Ëashington, DC nga data 2-5 nëntor. Zyrtarë të lartë që përfaqësojnë autoritetet zgjedhore nga vende të ndryshme të botës, parlamentarë, diplomatë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që merren me administrimin e zgjedhjeve patën mundësinë për të vëzhguar dhe për të mësuar rreth sistemit zgjedhor amerikan si dhe shkëmbimin e eksperiencave e ideve për zgjedhjet dhe votimin, mbi perspektivën krahasuese ndërkombëtare.
- Simpoziumi i 9-të Ndërkombëtar i Çështjeve Zgjedhore, që u mbajt në Cape Town të Afrikës së Jugut, bëri bashkë zyrtarë të lartë zgjedhorë nga vende të ndryshme të botës (midis tyre e ftuar dhe Kryetarja e KQZ-së Shqipëri), akademikë dhe ekspertë nga organizmat më të rëndësishme ndërkombëtare që operojnë në fushën e zgjedhjeve, të cilët përmes prezantimeve interaktive, seminareve, tryezave të rrumbullakëta dhe rasteve studimore, ndanë eksperiencat e diskutuan për sfidat e menaxhimit të sukseshmën të zgjedhjeve.  
Në vlerësim të performancës së trupës zgjedhore gjatë menaxhimit të zgjedhjeve dhe rezultateve të arritura, u zhvillua dhe ndarja e Çmimeve Ndërkombëtare Zgjedhore (International Electoral Awards), e cila kishte për qëllim vlerësimin e punës, arritjeve, iniciativat dhe përkushtimin e vazhdueshëm të organeve që menaxhojnë zgjedhjet. Kryetarja e KQZ-së dhe KQZ u vlerësuan me dy çmime të rëndësishme: Çmimin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Zgjedhjeve, "Election Management Award 2014", dhe Kryetarja e KQZ-së, znj. Luzi është vlerësuar edhe me çmimin për Menaxhim të Përsosur të Procesit Zgjedhor, "Award for Excellence in the Management of the Electoral Cycle".  
Fituesit e çmimeve janë përzgjedhur nga Komiteti i Çmimeve, në përbërje të së cilit ishin përfaqësues të Komisionit të Venecias, OSCE/ODHIR, IFES dhe shumë organizmave të tjerë prestigjiozë ndërkombëtarë, në bazë të vlerësimeve të bëra për zgjedhjet dhe organet e menaxhimit zgjedhor.

